



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

RAPORT MONITORIMI

“Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore për periudhën Janar – Gusht 2025”.

Ky raport paraqet situatën e realizimit të buxhetit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit deri më datë 31 Gusht 2025, bazuar në të dhënat e sistemit AFMIS dhe veprimtarinë e kryer gjatë periudhës. Raporti përfshin një analizë të plotë të realizimit të buxhetit sipas programeve buxhetore si dhe të dhëna ilustruese për performancën e secilit program.

Detajimi i buxhetit për vitin 2025 është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë, shtator 2021. Miratimi dhe administrimi i fondeve për vitin 2025 është realizuar sipas gjashtë programeve buxhetore ose niveleve arsimore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimi i synuar për vitin 2025, përfituesit, në objektiva të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2024, Strategjinë e Arsimit Parauniversitar, si dhe kërkesave për implementimin e ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr.10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar, ligjit nr.115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, si dhe Udhëzimit Plotësues nr.2, datë 19.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, është përgatitur raporti i monitorimit për periudhën Janar – 31 Gusht 2025, së bashku me anekset analitike, ku jepen të dhëna analitike të realizimit të fondeve për vitin 2024, plani fillestar i miratuar për vitin 2025, ndryshimet apo rishpërndarjet e fondeve gjatë vitit 2025, si dhe realizimin e fondeve të miratuara për 8- mujin Janar – 31 Gusht 2025, si dhe ndaj planit të rishikuar për vitin 2025.

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Për vitin 2025, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) ka administruar dhe menaxhuar fondetbuxhetore në kuadër të gjashtë programeve arsimore:

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”;
2. Programi “Arsimi Bazë”;
3. Programi “Arsimi i Mesëm i Lartë”;
4. Programi “Arsimi i Lartë”;
5. Programi “Kërkimi Shkencor”;
6. Programi “Për Zhvillimin e Sportit”.

Fondet për vitin 2025, të miratuara me ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, **pa përfshirë** të ardhurat dytësore të institucioneve të arsimit të lartë publik apo të institucioneve arsimore, fondet e ministrive të linjës për arsimin si dhe fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore për arsimin, **arrijnë në vlerën 62 miliardë e 20 milion lekë**. Kjo shumë përfaqëson **7.2% të totalit të shpenzimeve publike** dhe **2.2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB)**.

Struktura e fondeve sipas grupeve të artikujve të buxhetit për vitin 2025 paraqitet sa më poshtë:

a) **Shpenzimet korente për personelin** (600-601) arrijnë në 40,747 milion lekë, ose 66% të totalit të fondeve të miratuara;

b) **Shpenzimet korente për mallra**, shërbime, fonde grant për IAL publike dhe fonde për kërkimin shkencor (602-606) arrijnë në 15,968.9 milion lekë ose 26% të totalit të fondeve të miratuara;

c) **Fondet për investime kapitale** (230-231) janë në vlerën 5,304 milion lekë ose 9% të totalit të fondeve të miratuara për MAS. Nga këto, 4,684 milion lekë (91.4%) janë investime me financim të brendshëm, ndërsa 620 milion lekë (11.7%) janë fonde me financim të huaj.

Tabelat më poshtë paraqesin buxhetin e MAS të miratuar me ligjin 115/2014 “Për buxhetin e vitit 2025, sipas programeve buxhetore dhe natyrës së shpenzimeve.

Fondet buxhetore te miratura me ligjin nr.115/2024 "Per buxhetin e vitit 2025" (ne 000/LEK) sipas programeve buxhetore

Grupi	Kodi buxhetor	Emertimi i Institucionit / Programit	Shpenzimet korrente		Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Struktura ne % sipas programeve
			Shpenzime per paga dhe sigurime shoqerore	Shpenzime te tjera korrente		Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale		
11	11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	40,747,202	15,968,895	56,716,097	4,684,000	620,000	5,304,000	62,020,097	100%
11	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	984,179	111,021	1,095,200	55,000	0	55,000	1,150,200	1.90%
11	9120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	29,966,334	2,769,063	32,735,397	1,537,000	0	1,537,000	34,272,397	55.30%
11	9230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	9,722,599	359,401	10,082,000	1,362,000	0	1,362,000	11,444,000	18.50%
11	9450	Arsimi Universitar	0	11,550,000	11,550,000	1,180,000	300,000	1,480,000	13,030,000	21.00%
11	9770	Fonde per Shkencen	29,560	811,840	841,400	350,000	300,000	650,000	1,491,400	2.40%
11	8140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinise	44,530	367,570	412,100	200,000	20,000	220,000	632,100	1.00%
		Stuktura e fondeve buxhetore ne %	71.80%	28.20%	91.40%	88.30%	11.70%	8.60%	100.00%	0
		Stuktura e fondeve buxhetore ne %	66%	26%				9%		

Tabela nr. 2_ Fondet e miratuara me ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, në 000 lekë dhe në %, sipas natyrës së shpenzimeve

Fondet e miratuar ligjin nr. 115/2024 "Per buxhetin e vitit 2025"												
Emri i Programit												
Artikujt	2024 I rishikuar	2025	2026	2027	2025/2024 Fillestar	2025/2024	2026/2025	2027/2026	2025/2024 Fillestar	2025/2024	2026/2025	2027/2026
Paga (600-601)	35,345,528	40,747,202	40,747,202	40,747,202	31.4%	15.3%	0.0%	0.0%	9,747,000	5,401,674	0	0
Korente të Tjera (602-606)	17,937,855	15,968,895	16,068,895	16,548,713	2.9%	-11.0%	0.6%	3.0%	450,000	-1,968,960	100,000	479,818
Kapitale (230-232) Të Brendshme	4,863,010	4,684,000	4,484,000	3,484,000	-4.1%	-3.7%	-4.3%	-22.3%	-200,000	-179,010	-200,000	-1,000,000
Kapitale (230-232) Të Huaja	820,000	620,000	620,000	620,000		-24.4%	0.0%	0.0%	-200,000	-200,000	0	0
Totali	58,966,393	62,020,097	61,920,097	61,399,915	18.8%	5.2%	-0.2%	-0.8%	9,797,000	3,053,704	-100,000	-520,182

Periudha e Raportimit 8-2025 _ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë se Arsimit dhe Sportit per periudhën Janar-Gusht 2025													
Shpenzimet sipas programeve buxhetore		Ministria e Arsimit dhe Sportit Kodi i grupit 11 Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit											
		Viti paraardhës 2024		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportue	Periudha raportuese		Ndryshimi Vjetor	% e realizimit	
		Shpenzime	Strukt	Plani Fillestar	Struktur a eshpen në %	Plani Vjetor	Struktur a e shpenzi në %	Ndryshimi i planit	Shpenzime Faktike 8M M-G 2025	Strukt u shpenz në %	(Plan - Fakt)		
		Faktike	shpen z në %	Vjetor		i Rishikuar		vjetor					
				Viti 2025		Viti 2025							
		-1	-2	-3	-4	-5	-6	7 (5-3)	-8	-9	10 (5-8)	11 (8/5)	
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	972,956,724	1.80%	1,150,200,000	2%	1,097,841,876	2%	-52,358,124	660,499,370	2%	358,015,516	67.4%	
8140	Zhvillimi i Sportit	1,011,860,904	1.80%	632,100,000	1%	1,211,600,000	2%	579,500,000	1,005,768,966	2%	181,009,227	85.1%	
9120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	30,146,414,828	54.80 %	34,272,397,000	55%	35,311,397,000	55%	1,039,000,000	22,441,049,164	57%	10,477,382,443	70.3%	
9230	Arsimi i Mesem i Larte (AML)	8,732,483,761	15.90 %	11,444,000,000	18%	10,408,000,000	16%	- 1,036,000,000	6,228,423,088	16%	3,442,460,009	66.9%	
9450	Arsimi Universitar	13,101,996,959	23.80 %	13,030,000,000	21%	14,717,192,108	23%	1,687,192,108	8,317,689,957	21%	5,373,171,936	63.5%	
9770	Fonde per Shkencen	1,054,877,444	1.90%	1,491,400,000	2%	1,827,753,034	3%	336,353,034	815,371,990	2%	993,707,552	45.6%	
Totali i Shpenzimeve buxhetore te Ministrise (Kap 01,02,03,04,05,08,22)		55,020,590,619	100	62,020,097,000	100	64,573,784,018	100%	2,553,687,018	39,468,802,535	100%	20,825,746,683	61.1%	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)		3,363,895,724				3,038,766,153			1,882,338,135		1,156,428,018	61.9%	
Totali Shpenzimeve te Ministrisë		58,384,486,344		62,020,097,000		67,612,550,171		5,592,453,171	41,351,140,670			61.2%	
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik													
600	Paga	37,721,825,493	75%	35,410,317,000	62%	44,023,594,477	74%	- 8,613,277,477	28,773,716,935	77%	11,978,357,378	72.8%	
601	Sigurime Shoqërore	6,165,445,903	12%	5,336,885,000	900%	7,097,751,074	12%	- 1,760,866,074	4,742,103,803	13%	1,813,074,044	74.5%	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,982,545,539	6%	2,246,765,000	400%	4,117,307,467	7%	- 1,870,542,467	1,744,957,923.19	5%	2,234,710,941	45.7%	
603	Subvencione	0	0%	0	0%	0	0%	0	-	0%	0	!	
604	Transferta Korente të Brendshme	1,235,837,799	2%	12,306,210,000	2000%	1,127,834,538	2%	11,178,375,462	857,336,919.73	2%	201,027,963	82.2%	
605	Transferta Korente të Huaja	248,802,972	0%	235,200,000	0%	684,613,444	1%	-449,413,444	678,579,290.34	2%	5,879,299	99.1%	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,245,150,061	4%	1,180,720,000	200%	2,713,683,018	5%	- 1,532,963,018	901,285,561.00	2%	1,807,412,039	33.4%	
	Nen-Totali Shpenzime Korrente	50,599,607,767	100%	56,716,097,000	91	59,764,784,018	100%	- 3,048,687,018	37,697,980,432	100%	18,040,461,664	63.1%	
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0.0%	
231	Kapitale të Trupëzuara	4,135,642,992	8	4,684,000,000	8	4,409,000,000	92%	275,000,000	1,567,861,042	90%	2,588,246,078	33.5%	

	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	4,135,642,992	8	4,684,000,000	8	4,409,000,000	92%	275,000,000	1,567,861,042		2,588,246,078	35.6%
230	Kapitale të Patrupëzuara	270,375,690	1	0	0	0	0%	-				
231	Kapitale të Trupëzuara	14,962,520	0	620,000,000	1	400,000,000	8%	220,000,000	202,961,060	10%	197,038,940	
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te huaj	285,338,210	1	620,000,000	1	400,000,000	8%	220,000,000	202,961,060		197,038,940	50.7%
	Totali Shpenzime Kapitale	4,420,981,202	8	5,304,000,000	9	4,809,000,000	100%	495,000,000	1,770,822,102	100%	2,785,285,018	36.8%
Totali i Shpenz. Buxhetore te Ministrise/Institucionit Buxhetor		55,020,590,619	100	62,020,097,000	100	64,573,784,018		2,687,234,251	39,468,802,534		20,825,746,682	67.7%
	Shpenzime nga te Ardhetur Jashte limitit (Kap 06)	3,363,895,724				3,038,766,153			1,882,338,135		1,156,428,018	61.9%
Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz. nga te ardh. jashte limti		58,384,486,343		62,020,097,000		67,612,550,171		2,687,234,251	41,351,140,669	0	21,982,174,700	61.2%

1) Kuadri i përgjithshëm

Totali i buxhetit të rishikuar për vitin 2025 (përfshirë të ardhurat e IAL-ve publike) për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit është **67,612 miliard** lekë (ligji nr. 115/2024, i ndryshuar).

Shtesat/ndryshimet gjatë vitit 2025 janë +5,592 miliard lekë, të përbëra nga:

1. +2,232.2 miliard lekë, fonde grant të pashpenzuara nga viti 2024 nga IAL-të publike të cilat janë trashëguar apo autorizuar nga IAL-të;
2. +55 mln lekë “Fondi i veçantë 2025” (në zbaatim të Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 24.01.2025);
3. -20.99 mln lekë pakësim fonde për Investime (sipas Akt Normativ nr. 6, datë 11.06.2025);
4. +400 mln lekë programi “Zhvillimi i Sportit” (shtesë fondi me VKM nr. 536, datë 06.03.2025);
5. +2,959 mld lekë të ardhura të IAL-ve të përfituara gjatë periudhës Janar–Gusht 2025.

2) Struktura e buxhetit 2025 pas rishikimit, sipas artikujve buxhetore.

- **Shpenzime Personeli (600–601):** buxheti i rishikuar - **51,706,095,894 lekë** ose **76.5%** e buxhetit total;
- **Shpenzime për Mallra/Shërbime & grante të IAL -ve publike e organizatave sportive (602–606):** **4,645,824,532 lekë** ose **6.8%** e fondeve.
- **Investime kapitale: 6,316,533,664 lekë** ose **9.3%**, nga të cilat:
 - 4.409 mld lekë fonde me financim i brendshëm
 - 0.400 mld lekë fonde me financim i huaj
 - 1.507 mld lekë fonde për investime nga të ardhurat e IAL-ve

3) Realizimi i buxhetit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për periudhën **Janar–Gusht 2025** është në masën 41,351,140,670 lekë **ose 61.1% e buxhetit të rishikuar 2025.**

Detajimi i realizimit të buxhetit Janar –Gusht 2025

- **Shpenzime korente (600–606):** 39,155,044,420 lekë ose **63%** e planit vjetor.
 - Shpenzime Personeli (600–601): 34,099,326,178 lekë ose **66%** e planit;
 - Mallra/Shërbime & IAL (602–606): 5,055,718,250 lekë ose **53%** e planit.
- **Investime kapitale:** 2,196,096,242 lekë ose **35%** e planit, nga të cilat:
 - 1,567,861,042 lekë- realizimi i Financimit të brendshëm
 - 202.9 mln lekë realizimi i financimit të huaj
 - 425.2 mln lekë realizimi i investimeve nga të ardhurat e IAL-ve.

4) Shpenzimet e Personelit Janar-Gusht 2025

- Plani fillestar 2025 (pa rishpërndarje IAL): 40.747 mld lekë ose **65.6%** e totalit MAS.
- Buxheti i rishikuar për personelin: 51.704 mld lekë (**76.5%**) (përfshihen edhe grantet e rishpërndara dhe të ardhurat e IAL-ve që financojnë shpenzimet e personelit).
- Realizimi i shpenzimeve të personelit për periudhën Janar–Gusht: 34,099 mld lekë ose **66%** e planit vjetor të rishikuar.

5) **Numri i punonjësve** të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit (miratuar): **30,909**; ndersa numri mesatar i realizuar i punonjësve per periudhen 8-mujore është 30,240 pasi rreth 5% e personelit janë pozicione vakante ne sistemin arsimor.

- **Kategoritë e punonjësve të mbuluara me buxhet në vitin 2025:**
 - **26,768** punonjës mësimorë (Arsimi Bazë + Arsimi i Mesëm i Lartë)
 - **~2,200** mësues ndihmës;
 - **~850–950** punonjës psikosocialë;
 - **~220–440** oficerë sigurie;
 - **~2,300** mësues praktikantë (mbulim i kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për 3–9 muaj)
- ✓ **Aparati i MAS** ka strukturë organizative me 131 punonjës (miratuar me Urdher te KM nr. 215/13.12.2023; VKM nr. 523/22.09.2021)
- ✓ **AKAP:** 33 punonjës;
- ✓ **DRAP** (5) pesë kanë 115 punonjës;
- ✓ **ZVAP** (52) kanë 340 punonjës,
- ✓ **ASCAP** ka 15 punonjës

6) **Produktet/aktivitetet prioritare** të realizuara gjate periudhes Janar Gusht 2025 (mbuluar me shpenzime korente 602–606);

ARSIMI PARAUNIVERSITAR_(shpenzime te mbuluara me artikujt 602-606)

- **Transport nxënësish & mësuesish** (sipas VKM 119, 01.03.2023): plan 1,261.7 mln; rishikuar 1,215 mln; realizuar 715.1 mln (59%)
- **Tekste falas për nxënësit në AB & kategori të vecanta në AML:** plan 1,000 mln; rishikuar 1,000 mln; realizim kryhet ne periudhen Tetor-Nëntor;
- **Bursa & kuotë ushqimore** (nxënës me AK, nxënës në risk braktisje shkollore, etj): plan 280 mln lek; rishikuar 263 mln lek; realizuar 202 mln lek (77%).
- **Qendrat Burimore**_Instituti i Nxënësve që nuk Dëgjojnë/Shikojnë: plan 38 mln; rishikuar 36 mln; realizuar 12 mln (33%).
- **Kurrikula & Trajnime AB/AML:** plan 112 mln; rishikuar 112 mln; realizuar 48.4 mln (43%).
- **Trajnime/SMARTLab** (1–3): plan 120 mln; rishikuar 120 mln; realizuar 9.8 mln (8%).
- **Programi “Arti & Zejet”** (APU): plan 120 mln; rishikuar 120 mln; realizuar 25 mln (21%).
- **Matura Shtetërore** / Provime / Testime: plan 30 mln; rishikuar 30 mln; realizuar 10.4 mln (35%).
- **Dokumentacion shkollor & tekste për diasporën:** plan 28 mln; rishikuar 16 mln; realizuar 16 mln (100%).

ZHVILLIMI I SPORTIT (grante), artikull 604

- **Financim i Federatave Olimpike/Projekti Ekipet Sportive_KOKSH** (kualifikime në Lojrat Olimpike): plan 170 mln; rishikuar 570 mln; realizuar 454 mln (80%).
- **Aktivitete kombëtare/ndërkombëtare:** plan 60.4 mln; rishikuar 378 mln; realizuar 365 mln (96%).
- **Shpërblime sportistësh elitare:** plan 50 mln; rishikuar 50 mln; realizuar 28 mln (55%).
- **Programe trajnimi/ /Fondacioni “Durrak City FA”:** 80 mln (realizim 100%).
- **Agjencia e Sportit** (organizim eventesh): plan/rishikuar 51.8 mln; realizuar 21.2 mln (41%).

IAL PUBLIKE DHE KERKIM SHKENCOR (Grante) Artikull 604

- **Grant mësimdhënie** (fillestar): 11.550 mld lekë.
- **Grant mësimdhënie (rishikuar pas trashëgimit të fondeve nga viti 2024)**: 13.486 mld; realizuar 7.9 mld (59%) (Jan–Gusht).
- **Shpenzime Korente** + të ardhura të IAL (rishikuar 8-mujor): buxheti rishikuar 14.952 mld; realizuar 9.3 mld (62%).
- **Personeli në IAL** (grant i rishikuar): 10.960 mld; realizuar 7.012 mld (64%).
 - Nga buxheti i shtetit: 10.376 mld; realizuar 6.428 mld (62%)
 - Nga të ardhurat e veta: 584 mln; realizim 100% (peshë 5.4%)
- **Të tjera korente IAL**: 3.235 mld; realizuar 1.695 mld (52%) ku përfshihet edhe akomodimi studentor (~6.5–7 mijë studentë; me një fond prej 300 mln/vit)
- **Bursat studentore** (“Pakti për Universitetin”): plan 1.200 mld; rishikuar 1.362 mld; realizuar 757 mln (56%) perfitojnë rreth 11.000 studente
- **Bursa “Ekselencë & degë prioritare”** (sipas VKM nr. 386/01.06.2022):
 - 2022–2023: përfitues 157 studentë / 54.4 mln
 - 2023–2024: përfitues ~350 studentë / 150 mln
 - 2025: plan 180 mln; rishikuar 291 mln; realizuar 103.1 mln (35%) (8-mujor)
- **Kuota anëtarësie ndërkombëtare** (program Horizon Europe / Erasmus+): plan 230 mln; rishikuar 273 mln; realizim 100%.
- **Nxjtja e kërkimit shkencor në IAL publike**: 407 mln; realizuar 104 mln (26%).
- **Projekte Universitet–Biznes** (programe komb./ndërkombëtare, AKKSHI): 155 mln; realizuar 27 mln (17%).

Objektiva & Rezultate të synuara 2025 në arsim (përmbledhje)

1) Arsimi Parauniversitar (parashkollor, arsimi baze dhe i mesëm)

- **Akses & gjithëpërfshirje**: parashkollor **86%**; AB **100%** (6–16 vjeç); fokus te romë/egjiptianë dhe AK.
- **Kurrikul & trajnim**: implementim i kornizës së re (1–5; 6–9); **9–12 mijë** mësues/ vit (25% e AB), **600–900** mësues ndihmës; **40** mësues të pakicave; **80–100** mësues të diasporës.
- **Tekste shkollore**: klasat I–IX (modeli falas/ri-përdorim); AML: **14–16 mijë** përfitues nga kategori të veçanta.
- **Transport**: ~35 mijë nxënës + **11.8–12.4 mijë** mësues (mbulim 100%).
- **Arsimi i mesëm**: pjesëmarrja target **95–98%** e përfunduesve të AB (76% gjimnaze / 24% profesional).
- **Klasa sportive**: rritje në **423** (nga 223).
- **Matura 2025**: ~30 mijë maturantë; target rritje mesatare **7.26 → 7.50**.

2) Arsimi i Lartë & Kërkimi shkencor

- **Arsimi i lartë**: bursat 18–20% e studentëve (cikli I/II); akreditim **90–100** programe/vit; 100% të dhënave në regjistër elektronik **brenda 2025**; raport student/pedagog **15:1**; rritje mobiliteti **+20% (2024–2025)**, **+40% (2025–2026)**, **+60% (2026–2027)**; synim financim IAL **1% e PBB** (2025–2027).
- **Kërkimi Shkencor**: 3,500–4,000 kërkues të financuar; prioritet femrat; laboratorë & integritet akademik.

3) **Sporti:** Kalendar i plotë kombëtar/ndërkombëtar; antidoping; investime infrastrukturore; shpërblime për sportiste elitare.

A. Tabela e Kuadrit të përgjithshëm të buxhetit

Buxheti i rishikuar (me të ardhurat e IAL-ve)	67,612,000,000 lekë
Shtesë/ndryshime neto gjatë vitit	+5,592,000,000 lekë
Realizim Janar–Gusht 2025	41,351,140,670 lekë (61.1%)
Burime shtesë	Grante IAL, AK, VKM, të ardhura IAL

B. Struktura e buxhetit pas rishikimit

Grup zëri	Buxheti rishikuar	Pesha
Personeli (600–601)	51,706,095,894	76.5%
Mallra/Shërbime & grante IAL 602-606	4,645,824,532	6.8%
Investime kapitale 230,231	6,316,533,664	9.3%

C. Realizimi Janar–Gusht 2025 (sipas strukturës)

Grup zëri	Realizim	% ndaj planit
Shpenzime korente (600–606)	39,155,044,420	63%
Personeli (600–601)	34,099,326,178	66%
Mallra/Shërbime & IAL	5,055,718,250	53%
Investime kapitale	2,196,096,242	35%

D. Shpenzimet e personelit & Burimet njerëzore

Plan fillestar personeli 2025	40,747,000,000 lekë
Buxheti i rishikuar personeli	51,704,000,000 lekë
Realizim Janar–Gusht	34,099,326,178 lekë (66%)
Numri i punonjësve të miratuar	30,909
Mesatarja e realizuar 8-mujore e nr. punonjësve	30,242

Tabela 1. Fondet e miratuar me ligjin 115/2024 “Per buxhetin e vitit 2025” , te ndryshuar, ne leke sipas programeve dhe artikujve buxhetor per Ministrine e Arsimit dhe Sportit

Kodi i Progr	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 230	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 604	Art. 605	Art. 606	Total
	Te ardhura jashtë limiti		Shp. Faktike					3,688,430				3,688,430
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Plani fillestar	-	55,000,000	853,768,000	130,411,000	110,301,000	0	0	720,000	1,150,200,000
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Plani i rishikuar	-		853,768,000	130,411,000	113,089,430	0	0	4,261,876	1,101,530,306
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Shpenzime faktike	-	0	516,013,268	85,108,491	60,066,085	0	0	2,999,955	664,187,800
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Angazhime	-	0	0	0	5,205,058	0	0	0	5,205,058
	Ndryshimi ne vlere absolute	2025		-	-	337,754,732	45,302,509	47,818,287	-	-	1,261,921	432,137,448
	Realizimi ne %	2025		-	0	60%	65%	53%			70%	60%
	Te ardhura jashtë limiti		Shp. Faktike							1,104,916		1,104,916
8140	Zhvillimi i Sportit	2025	Plani fillestar	-	220,000,000	40,450,000	4,080,000	2,000,000	360,370,000	5,200,000	0	632,100,000
8140	Zhvillimi i Sportit	2025	Plani i rishikuar	-	81,400,000	39,050,000	4,080,000	2,000,000	679,474,916	406,600,000	100,000	1,212,704,916
8140	Zhvillimi i Sportit	2025	Shpenzime faktike	-	0	12,244,320	2,029,090	700,468	588,531,134	403,301,995	66,875	1,006,873,882
8140	Zhvillimi i Sportit	2025	Angazhime	-	0	0	0	0	0	0	0	0
	Ndryshimi ne vlere absolute	2025		-	81,400,000	26,805,680	2,050,910	1,299,532	90,943,782	3,298,005	33,125	205,831,034
	Realizimi ne %	2025		-	0%	31%	50%	35%	87%	99%	67%	83%
	Te ardhura jashte limiti	2025	Shpenzime faktike	-	0	161,000	0	0	15,189,119			15,350,119
9120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	2025	Plani fillestar	-	1,537,000,000	26,032,760,000	3,933,574,000	1,869,063,000	0	0	900,000,000	34,272,397,000
9120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	2025	Plani i rishikuar	-	1,477,161,000	26,732,760,000	4,283,574,000	1,894,142,119	0	110,000	939,000,000	35,326,747,119
9120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	2025	Shpenzime faktike	-	547,286,271	17,871,552,513	2,977,138,651	1,030,737,168	0	99500	29,585,180	22,456,399,283
9120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	2025	Angazhime	-	259,940,925	0	0	79,861,865	0	0	0	339,802,790
	Ndryshimi ne vlere absolute	2025		-	669,933,804	8,861,207,487	1,306,435,349	783,543,086	0	10,500	909,414,820	12,530,545,046

	Realizimi ne %	2025		-	37%	67%	70%	54%		90%	3%	64%
	Te ardhura jashte limiti	2025	Shpenzime faktike					112,000				112,000
9230	Arsimi i Mesem i Larte (AML)	2025	Plani fillestar	-	1,362,000,000	8,457,555,000	1,265,044,000	259,401,000	0	0	100,000,000	11,444,000,000
9230	Arsimi i Mesem i Larte (AML)	2025	Plani i rishikuar	-	1,362,000,000	7,457,555,000	1,215,044,000	259,513,000	0	0	114,000,000	10,408,112,000
9230	Arsimi i Mesem i Larte (AML)	2025	Shpenzime faktike	-	521,620,568	4,803,283,059	801,509,449	91,975,523	0	0	10,146,489	6,228,535,088
9230	Arsimi i Mesem i Larte (AML)	2025	Angazhime	-	543,644,568	0	0	6,694,505	0	0	0	550,339,073
	Ndryshimi ne vlere absolute	2025		-	296,734,864	2,654,271,941	413,534,551	160,842,972	-	-	103,853,511	3,629,237,839
	Realizimi ne %	2025		-	38%	64%	66%	35%			9%	60%
			Plani Fillestar		1,480,000,000			11,550,000,000				13,030,000,000
9450	Arsimi Universitar	2025	Plani i rishikuar	7,078,770	2,698,380,216	9,441,845,533	1,518,448,361	1,961,047,128	659,367,535	8,556,550	1,362,618,640	17,657,342,734
9450	Arsimi Universitar	2025	Shpenzime faktike	2,604,913	811,746,767	6,080,962,238	931,415,779	975,533,042	548,567,535	6,469,803	757,844,391	10,115,144,469
9450	Arsimi Universitar	2025	Angazhime	4,473,857	1,661,411,016	0	0	332,774,643	0	0	0	1,998,659,516
	Ndryshimi ne vlere absolute	2025		-	1,661,411,016			652,739,444	110,800,000	2,086,747	604,774,249	3,031,811,455
	Realizimi ne %	2025			30%	64%	61%	50%	83%	76%	56%	57%
9770	Fonde per Shkencen	2025	Plani fillestar	-	650,000,000	25,784,000	3,776,000	6,000,000	395,840,000	230,000,000	180,000,000	1,491,400,000
9770	Fonde per Shkencen	2025	Plani i rishikuar	1,077,864	689,433,814	25,784,000	3,776,000	416,032,855	199,464,538	274,239,194	296,304,831	1,906,113,096
9770	Fonde per Shkencen	2025	Shpenzime faktike	1,077,864	311,759,859	15,584,689	2,484,630	105,292,208	65,710,702	273,600,292	104,489,903	880,000,148
9770	Fonde per Shkencen	2025	Angazhime	-	26,899,048	0	0	5,177,976	0	0	0	32,077,024
	Ndryshimi ne vlere absolute	2025		-	350,774,907	10,199,311	1,291,370	305,562,670	133,753,836	638,902	191,814,928	994,035,924
	Realizimi ne %	2025			45%	60%	66%	25%	33%	100%	35%	46%
	Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Plani fillestar	-	5,304,000,000	35,410,317,000	5,336,885,000	13,796,765,000	756,210,000	235,200,000	1,180,720,000	62,020,097,000
	Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Plani i rishikuar	8,156,634	6,308,375,030	44,550,762,533	7,155,333,361	4,645,824,532	1,538,306,989	689,505,744	2,716,285,347	67,612,550,171
	Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Shpenzime faktike	3,682,777	2,192,413,465	29,299,640,088	4,799,686,090	2,264,304,494	1,202,809,371	683,471,591	905,132,793	41,351,140,670
	Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Angazhime	4,473,857	2,491,895,557	-	-	429,714,047	-	-	-	2,926,083,461
	Realizimi Te ardhurat	2025	Te ardhurat	3,682,777	421,591,363	525,923,153	57,582,287	519,346,571	345,472,451	4,892,300	3,847,232	1,882,338,135
	Ndryshimi ne vlere absolute	2025		-	1,624,066,008	15,251,122,445	2,355,647,271	1,951,805,991	335,497,618	6,034,154	1,811,152,554	23,335,326,040
	Realizimi ne %			45.2%	34.8%	65.8%	67.1%	48.7%	78.2%	99.1%	33.3%	61.2%

Objektivat dhe Produktet/ Aktivitetet/ Shërbimet që janë financuar me përparësi, në grupin e shpenzimeve korente për vitin 2025;

1.Arsimi Parauniversitar (Arsimi Bazë + Arsimi i Mesëm i Lartë)

Rezultatet e planifikuara që synohet të arrihen për vitin 2025;

1. Të sigurohet **rritja e aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor** në masën 86%, ndjekja e arsimit bazë e grupmoshës 6-16 vjeç në masën 100%, si dhe përfshirja me përparësi e grupeve vulnerable. Rritja e treguesit të regjistrimit të fëmijëve për nxënësit romë dhe egjiptianë si dhe për nxënësit me AK.
2. Reformimi i arsimit parashkollor dhe arsimit bazë, përmes miratimit të kornizës së re kurrikulare dhe programeve për çdo grupmoshe për arsimin parashkollor dhe arsimin bazë, **trajnimin të përvitshëm të mësuesve/edukatorëve dhe punonjësve të shërbimit psiko-social** (250 psikologë dhe 250 punonjës social) dhe pajisjes me materiale didaktike të kopshteve dhe shkollave.
3. **Zbatimi/implementimi i kurrikulës** së re (klasa 1-5 dhe klasa 6-9) përgatitja e programeve kualifikuese, moduleve dhe testet trajnuese për kurikulën e re.
4. **Trajnimi çdo vit i afro 9-12 mijë mësuesve të klasës 1-9 (trajnimi 25% i mësuesve të AB) për kurrikulën e re**, përfshirë edhe 40 mësues të pakicave kombëtare, si dhe **600-900 mësues ndihmës për fëmijët** me AK. Trajnimi i 80-100 mësuesve të diasporës në seminarin mbarëkombëtar për mësuesit e diasporës.
5. **Zhvillimi i reformës së teksteve shkollore**, përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së teksteve shkollore si dhe kompensimi i çmimit të teksteve shkollore për klasat I-IX. Qysh në vitin shkollor 2021-2022, janë përfshirë në skemën e ofrimit në përdorim falas rreth **220-230 mijë nxënës të arsimit të arsimin** parainiversitar , nga të cilët për vitin 2023-2024 nxënësit e **klasës së pare, klasës së dytë dhe klasës së tretë do të jenë falas pa rikthim**, ndërsa nga klasa e katër deri në klasën e nëntë janë falas me detyrim rikthim dhe ripërdorim në masën 2-3 vite.
6. **Në arsimin e mesëm të lartë**, parashikohen të përfitojnë tekste falas rreth 14-16 mijë nxënës nga kategoritë e veçanta që ndjekin institucionet publike në arsimin e mesëm të lartë, duke lehtësuar ndjeshëm barrën financiare të familjeve. *(Plani i Qeverisë 2021-2025 _Objektivat për arsimin)*. Dhënia e teksteve shkollore falas, për nxënësit të arsimit të mesëm të lartë, në masën 100 % të nxënësve që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie, nxënësve që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, nxënësve që gëzojnë statusin e të verbrit, atyre nga pakicat kombëtare, nxënësit romë, egjiptianë, fëmijëve të familjeve të emigrantëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, fëmijët që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie; fëmijë të familjeve që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuar, fëmijë që vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura; familje në nevojë, viktimave të trafikimit.

7. **Garantimi i transportit për afro 35 mijë nxënësve dhe fëmijë, që ndjekin arsimin parashkollor dhe arsimin bazë, që mësojnë në një distancë prej më shumë se 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre si dhe 11 800 deri 12 400 mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës, duke përballuar 100% shpenzimet e transportit me fondet e buxhetit të shtetit.**
8. **Numri i nxënësve që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë synohet të arrijë 95-98% e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë, nga të cilët 76% ndjekin AM gjimnaze dhe 24% në arsimin profesional.**
9. **Rritja e numrit të klasave të profilizuara sportive në 423 klasa sportive, në mënyrë progresive në të gjithë vendin, nismë e cila ka filluar në vitin shkollor 2021-2022, nga 223 në 423 klasa sportive, duke shtuar edhe disiplina të reja sportive, si gjimnastikë, atletikë dhe tenis. (Plani i Qeverisë 2021-2025 _Objektivat për arsimin).**
10. **Realizimi i Maturës Shtetërore 2025, sipas kurikulës së re me bazë kompetencën për 30 mijë nxënës që përfundojnë arsimin e mesëm të lartë. Përmirësimi i rezultateve në provimet e maturës shtetërore duke rritura notën mesatare nga 7.26 aktualisht në 7.5 në vitin 2025.**

Realizimi i produkteve dhe aktiviteteve që janë financuar me përparësi, për vitin 2025;

- 1) **Fonde për të mbuluar shpenzime për transportin 35 mijë nxënësve, që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin për rreth se 12 mijë mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë, konform kërkesave të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 në shumën 1 miliard 261.7 milion lekë në vit, fondet e rishikuara arritën në 1 miliard e 215 milion lekë dhe fondet e realizuara arritën në 715,1 milion lekë ose 59% e fondeve të miratuara për vitin 2025 për 8-mujorin 2025.**
- 2) **Fonde për të mbuluar shpenzimet për blerjen e teksteve shkollore për rreth 220-230 mijë nxënësve nga klasa e parë në klasën e tretë falas çdo vit si dhe nga klasa e katër në klasën e nëntë në përdorim falas, si dhe për nxënësit nga shtresat sociale në nevojë që ndjekin arsimin e mesëm të lartë ku përfitojnë 14-15 mijë, shuma e parashikuar prej 1 miliard lekë në vit, fondet e rishikuara mbetën 1 miliard lekë, këto fonde realizohen në muajin Shtator Tetor 2025.**
- 3) **Fonde për të mbuluar shpenzimet për bursa, kuotë ushqimore të nxënësve me nevoja të vecanta si dhe fëmijëve më me ndikim në uljen e braktisjes shkollore, për rreth 3800-4000 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë shuma parashikuar prej 280 milion lekë në vit, fondet e rishikuara arritën në 263 milion lekë dhe fondet e realizuara arritën në 202 milion lekë ose 77% e fondeve të rishikuara për vitin 2025;**
- 4) **Fonde për të mbuluar shpenzimet për shërbimin arsimor të nxënësve me nevoja të vecanta si dhe fëmijëve më me ndikim në uljen e braktisjes shkollore, në qendrat burimore (Institutin e nxënësve që nuk Dëgjojnë , Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë”), fondet janë parashikuar prej 38 milion lekë në vit, fondet e rishikuara arritën në 36 milion lekë dhe fondet e realizuara arritën në 12 milion lekë ose 33% e fondeve të rishikuara për vitin 2025.**
- 5) **Fonde për të mbuluar shpenzimet për hartimin e programeve dhe rishikimin e kurikulës të arsimit para-universitar për veprimtarinë “Mësues të arsimit baze të trajnuar për kurrikulen e re”, “Kurrikula lëndore dhe programe të hartuara”, “Mësues të AML të trajnuar për kurrikulen e kl.10_kl 11_kl 12”, “Kurrikula dhe programe arsimore të hartuara në AML”, me 112 milion lekë në vit, fondet e rishikuara mbetën 112 milion lekë dhe fondet e realizuara arritën në 48,4 milion lekë ose 43% e fondeve të rishikuara për vitin 2025.**

- 6) **Fonde për të mbuluar shpenzimet për trajnimin çdo vit të 20-25% të punonjësve** mësimorë të arsimit para-universitar si dhe programit SMARTLab klasa e parë deri në klasën e tretë **120 milion lekë në vit**, fondet e rishikuara 120 milion lekë dhe fondet e realizuara 9,8 milion lekë ose 8% e fondeve të rishikuara për vitin 2025.
- 7) **Fonde për të mbuluar shpenzimet “Institucione arsimore të arsimit bazë përfitues në programin "Arti dhe Zejet" për periudhën 2024-2027; në arsimin para-universitar 120 milion lekë në vit**, fondet e rishikuara 120 milion lekë dhe fondet e realizuara 25 milion lekë ose 21% e fondeve të rishikuara për vitin 2025.
- 8) **Fonde për të mbuluar shpenzimet për veprimtarinë e Maturës Shtetërore**, provimet e shtetit si dhe testime kombëtare e ndërkombëtare janë **30 milion lekë në vit**, fondet e rishikuara 30 milion lekë dhe fondet e realizuara 10,4 milion lekë ose 35% e fondeve të miratuara për vitin 2025.
- 9) **Fonde për të mbuluar shpenzimet për blerje dokumentacionit shkollor**, kontribut financiar për blerje tekste shkollore për fëmijët në diasporë”, ishin planifikuar **28 milion lekë në vit**, fondet e rishikuara arritën në 16 milion lekë dhe fondet e realizuara 16 milion lekë ose 100% e fondeve të rishikuara për vitin 2025.

3. **Arsimi i Lartë dhe Kërkimi shkencor (Objektivat dhe produktet/ aktivitetet/ shërbimet për vitin 2025)**

1. **Rritja e cilësisë së mësimdhënies në Arsimin e Lartë**, nëpërmjet kualifikimit shkencor të stafit akademik, me 5% deri 10% në vit dhe rritjes së numrit të stafit akademik me kohë të plotë, duke synuar uljen e raportit mesatar akademik, pedagog me kohë të plotë sipas standarteve të Kodit të Cilësisë në arsimin e lartë.
2. **Garantimi i aksesit në bazë të meritës dhe rritja e dimensionit social në arsimin e lartë** duke mbështetur me bursë financiare nxënësit që ndjekin studimet në arsimin e lartë nga kategoritë sociale në nevojë, në masën 18% - 20% të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë dhe **në përputhje edhe me parimet e barazisë gjinore**;
3. **Nxitja e punës kërkimore në IAL publike**, nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3500 - 4000 kërkuesve, ku **prioritet në shpalljen e projekteve fituese në përputhje me parimet e barazisë gjinore kanë femrat**, si dhe mbështetje financiare për kërkim fundamental në IAL publike me fonde nga buxheti i shtetit;
4. **Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë**; vijnë punën për hapjen e filialeve të Universiteteve më të mira ndërkombëtare në Shqipëri, si dhe për programme studimi të përbashkëta dhe të dyfishta me to. MAS do të mbështesë hapjen e programeve në gjuhën angleze në të gjitha universitetet shqiptare. (*Plani i Qeverisë 2021-2025 _Objektivat për arsimin*);
5. **Rritja e aplikimeve në programin “Horizon Europe” , program për Kërkimin dhe Inovacionin 2021-2027**. Programi kuadër “Horizon Evropë” do të bashkojë kërkimin me inovacionin dhe do të ketë një akses më të thjeshtë se programet paraardhëse për kompanitë dhe universitetet .
6. **Akreditimi cdo vit i 90-100 programeve të studimit** (ose 10% e programeve të studimit të miratuar aktualisht) në IAL publike dhe private, me synim që të akreditohen 100% të programeve brenda vitit 2030;
7. **Zgjerimi i bashkëpunimit të Universiteteve me biznesin privat përmes Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit**, duke organizuar edhe seminare dhe takime

informuese në IAL si dhe rritja e fondeve dhe mbështetja financiare për këto pragame me rreth 10-15% më shumë se viti paraardhës;

8. **Investime në laboratorë për kërkimin shkencor dhe me sigurimin e integritet akademik** dhe shkencor të universiteteve, do të përmirësohet cilësia e produktit universitar me qëllim që diploma e çdo studenti të mbartë vlerën që duhet të ketë. (*Plani i Qeverisë 2021-2025 _Objektivat për arsimin*)
9. **Investime në infrastrukture në kampuset/godinat universitare**, do të përmirësohet eksperiencia studentore dhe do të inkurajohen të rinjtë të ndjekin ëndrrat e tyre në kampuset universitare shqiptare. (*Plani i Qeverisë 2021-2025 _Objektivat për arsimin*).
10. **Përmirësimi i standardeve infrastrukture**, duke rritur raportin sipërfaqe/student së paku me 1 metër katror/student dhe vende për punë dhe kërkim në laboratorë e biblioteka. Do të synohet të sigurohet standardi 5-8 m² për student, sipas natyrës së programit të studimeve në vitin 2025-2027, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.
11. **Synohet të sigurohet standardi, një** vend pune për dy studentë në laborator kërkimorë shkencorë, në përputhje me Kodine Cilësisë si dhe parimet e barazisë gjinore;
12. Synohet që fondet publike për IAL të arrijnë në 1% ndaj PBB në vitin 2025-2027;
13. Synohet që 100% e të dhënave të stafit akademik, të studentëve, të karrierës akademike, diplomimit, të përfshihen në regjistrin elektronik kombëtar, brenda vitit 2025.
14. Synohet që 90% e stafit akademik me kohë të plotë, në departamente të jenë me grada/tituj brenda vitit 2025, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.
15. Rritja e mobilitetit të stafit dhe studentëve me 20% në vitin akademik 2024-2025, rritje me 40% në vitin akademik 2025-2026 dhe 60% në vitin akademik 2026-2027.
16. **Financimi në masën 100% e studentëve ekselencë, studentëve që studiojnë në degë dhe programet prioritare**, si dhe studentët në nevojë do të përfitojnë bursa studentore në periudhën 2024-2026;
17. **Synohet që në vitin 2025, Raporti student/pedagog të brendshëm të arrijë 1** pedagog për 15 studentë.
18. Synohet që numri i kërkuesve shkencorë për 1000 banorë deri në vitin 2026 të arrijë në nivelin e mesatares së vendeve të OECD;

Realizimi i buxhetit per periudhën Janar-Gusht 2025_Arsimi i Lartë &Kërkimi Shkencor

- 1.Fondet “grant për mësimdhënie”, për IAL publike për vitin 2025, pjesë e shpenzimeve korente për MAS janë miratuar në masën **11 miliard e 550 milion lekë, ku pjesa kryesore e tyre shkon për të mbuluar shpenzimet e personelit në IAL publike, në shumën 9.5 deri 9.8 miliard lekë** dhe shpenzime të tjerë të domosdoshme për funksionimin e IAL publike.
- 2.Fondet e rishikuara “grant për mësimdhënie”, për IAL publike për vitin 2025, pas rimarrjes të fondeve të trashëguara nga viti 2024, janë **13 miliard e 486 milion lekë** dhe fondet e realizuara janë 7,9 miliard lekë ose 59% e fondeve të miratuara për vitin 2025, për periudhën janar-gusht.
- 3.Fondet e rishikuara për 8-mujorin 2025 (së bashku me të adhurat e IAL, autorizuar për mbulimin e shpenzimeve korente) arritën në 14 miliard e 952 milion lekë dhe fondet e realizuara arritën në 9,3 miliard lekë ose 62% e fondeve të rishikuara për vitin 2025.
- 4.Sipas natyrës së shpenzimeve, këto fonde janë realizuar sa vijon;
- 5.Fondet për shpenzime personeli në IAL publike të rishikuara “grant për mësimdhënie”, për vitin 2025, janë **10 miliard e 960 milion lekë**, realizimi vjetor është në masën 7 miliard e 12 milion lekë, ose 64% e fondeve të rishikuara. Për shpenzime personeli me burim nga

buxheti i shtetit, nga organet drejtuese të IAL-ve publike janë planifikuar fonde në masën 10 miliard e 376 milion lekë dhe realizimi për periudhën janar-gusht 2025 është në masën 6 miliard e 428 milion ose 62% e buxhetit të rishikuar ndërsa me burim të ardhurat e veta, nga të gjithë IAL_të publike janë planifikuar 584 milion lekë të cilat janë realizuar në masën 100%. Pjesa që zënë pagesat nga të ardhurat e veta të IAL-ve publike në shpenzimet e personelit është 5,4% e fondeve të planifikuara për vitin 2025.

6.Fondet për shpenzime të tjera të domosdoshme për funksionimin e IAL publike, për vitin 2025, arrijnë në **shumën 3 miliard e 235 milion lekë**, realizimi vjetor është 1 miliard e 695 milion lekë ose 52%, ku përfshihen edhe të ardhurat e autorizuara. Në grupin e fondeve grant për shpenzime të tjera të domosdoshme, janë përfshirë dhe fondet grant për të mbuluar shpenzimet e studentëve për akomodimin në tetë “Shoqëritë e Trajtimit të studentëve në Tiranë dhe në Rrethe”, ku janë akomoduar rreth 6,5-7 mijë studentë, me mbështetje financiare vjetore **prej 300 milion lekë në vit.**

7.Fondet për mbulimin e bursave financiare për studentët në kuadrin e “Paktit për Universitet”, me **rreth 1 miliard e 200 milion lekë në vit**, ku përfitues parashikohen të jenë 11 800 deri 12 000 studentë, fondi i rishikuar për vitin 2025 arrin në masën **1 miliard e 362 milion lekë** fondet e realizuara janë **757 milion lekë** ose 56% e fondit vjetor. Ky fond u jep mundësinë financiare studentëve për të ndjekur studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, **në një program të ciklit të parë, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale**, kategori të caktuara të studentëve sipas rezultateve dhe studentëve nga kategoritë sociale në nevojë, të cilët nuk kanë mundësi financiare për të përballuar një pjesë të kostos të studimeve kostot e shkollimit, sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” i ndryshuar.

8.Financimi me bursa financiare, për studentët ekselentë si dhe ato studiojnë në programe të përcaktara prioritet kombëtar, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 386, datë 1.6.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyere studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar. **Për vitin akademik 2022-2023 kanë përfituar bursë sipas këtij vendimi rreth 157 studentë me fondin prej 54.4 milion lekë**, për vitin akademik 2023-2024 me ndryshimin e kriterëve të vendimit të cituar më lart përfitojnë bursë rreth **350 studentë** me një në masën e pagës minimale form **prej 40,000 lekë në muaj me një fond prej 150 milion lekë. Për vitin 2025 janë planifikuar 180 milion lekë, fondet e rishikuara për vitin 2025 janë në masën 291 milion lekë, fondet e realizuara për 8-mujorin 2025, janë në masën 103,1 milion lekë ose 35% e fondit vjetor.**

9.Fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër “Horizon EUROPE”, fonde për pjesëmarrjen në marrëveshje në Programin "Erasmus+ për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin”, për vitin 2025 parashikuar pagesa kuota anëtarësie/ transferta ndërkombëtare shuma **230 milion lekë në vit, fondet e rishikuara arritën në masën 273 milion lekë dhe realizimi është 100% e buxhetit të rishikuar 2025.**

10. Financimi i Programeve Kombetare/Nderkombetare të Bashkepunimit Shkencor e Teknologjik të mbështetura financiarisht. Për vitin 2025, nxitja e punës kërkimore në IAL publike nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3,500-4 000 kërkuesve, ku prioritet në përputhje me parimet e barazisë gjinore kanë femrat, si dhe mbështetje financiare për kërkim

fundamental në IAL publike, janë planifikuar 407 milion lekë dhe fondet e realizuara janë në masën 104 milion lekë ose 26%.

11. **Projekte bashkëpunimi të Universiteteve me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, Programet Kombëtare dhe Ndërkombëtare.** Zgjerimi i bashkëpunimit të Universiteteve me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, nëpërmjet organizimit të seminareve dhe takimeve informuese në IAL mbi Programet Kombëtare dhe Ndërkombëtare, rritja me 10-15% më shumë ndaj viti paraardhës, janë parashikuar 155 milion lekë në vit, këto fonde grant shpërndahen me vendim Bordit të Administrimit të AKKSHI-t dhe fondet e realizuara janë në masën 27 milion lekë ose 17%

4.SPORTI (Objektivat dhe produktet/ aktivitetet/ shërbimet për vitin 2025)

- 1) **Sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpike për vitin 2025** në aktivitete, Evropiane, Botërore, Ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpike, realizimi i 30-35 analizave antidoping për sportistët elitar si dhe ato kandidat për lojërat olimpike veror 2025.
- 2) **Mbështetja financiare për Ekipin Kombëtar Olimpik, për vitin 2025**, pjesëmarrës në Lojërat Olimpike dhe lojërat olimpike verore, mbështetje për aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive, në të gjithat disiplinat sportive, sipas kalendarëve të aktiviteteve në 42 Kampionate Kombëtare, 42 Kupa të Shqipërisë, 42 Kampionate Evropiane si dhe 42 Kampionate Botërore, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.
- 3) **Mbështetja financiare me investime në sport, për vitin 2025**, për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive, si dhe pajisjen me bazë materiale të tyre në funksion të ekipeve kombëtare.
- 4) **Zhvillimi i programeve trajnuese në sistemin sportiv kombëtar në funksion** të rritjes së kapaciteteve në fushën e sportit, trajnime çdo vit për 20-25% e stafit teknik të sistemit sportiv kombëtar (732 teknike-trajnerë, specialistët, instruktorët, mjekët etj, ku përparësi kanë sportistët dhe trajnerët femra).
- 5) **Rritja e mbështetjes financiare për shpërblimin e sportistëve elitar**, fitues në aktivitete ndërkombëtare, mbështetje financiare për të gjithë sportistë elitarë, sipas kriterëve të miratuara në VKM nr. 789, datë 15.12.2021 si dhe mbështetje financiare për aktivitete sportive promovuese dhe garuese në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar dhe atij universitar.
- 6) **Mbështetja me infrastrukturën e nevojshme materiale dhe njërzore për projektin “Ekipet Sportive”**, projekt i cili menaxhohet nga KOKSH-i me mbështetjen edhe të shkollave, zyrave dhe drejtorive arsimore si dhe MAS.
- 7) **Përmirësimi i cilësisë së jetës së sportistëve dhe të rinjve në sport**, përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre, në punësim, informim, edukim dhe vendimarrje.

Realizimi për periudhën Janar-Gusht 2025_Sporti.

1. **Financimi i veprimtarisë për sportin, “Federata Olimpike dhe jo-Olimpike që marrin pjesë në aktivitete ndërkombëtare”**, sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpike në aktivitete, Evropiane, Botërore, Ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpike verore, për vitin 2025 janë parashikuar për tu financuar me fonde grand nga buxheti i shtetit 170 milion lekë në vit, fondet e rishikuara janë në masën 570 milion lekë dhe fondet e realizuara janë në masën 454 milion lekë ose 80%.

2. **Financimi i “Aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare te zhvilluara për të gjitha disiplinave sportive”,** janë parashikuar për tu financuar me fonde grand nga buxheti i shtetit në shumën prej 60.4 milion lekë ne vit, fondet e rishikuara janë në masën 378 milion lekë dhe fondet e realizuara janë në masën 365 milion lekë ose 96% e buxhetit të rishikuar 2025.
3. **Rritja e mbështetjes financiare për shpërblimin e sportistëve elitar,** fitues në aktivitete ndërkombëtare, mbështetje financiare për 35-40 sportistë elitarë dhe trajnerët e tyre, janë parashikuar për tu financuar me fonde grand nga buxheti i shtetit në shumën 50 milion lekë ne vit, fondet e rishikuara janë në masën 50 milion lekë dhe fondet e realizuara janë në masën 28 milion lekë ose 55% e planit.
4. **Zhvillimi i programeve trajnuese në sistemin sportiv kombëtar** si dhe mbështetja financiare për federatat jo-olimpikë shqiptare, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) dhe financimi i veprimtarisë së Fondacionit “Durrëh City Football Accademy”, Durrës, për vitin 2025 janë parashikuar 80 milion lekë dhe realizimi është 100% (fondet transferohen në bankëtë nivelit të dytë).
5. **Mbështetje financiare, për veprimtarinë e Agjencisë së Sportit** “Sigurimi i mbështetjes financiare për organizimin e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare”, janë planifikuar 51.8 milion lekë në vit, fondi i rishikuar është 51.8 milion lekë, realizimi në masën 21,2 milion lekë ose 41% e fondeve të rishikuara për vitin 2025.

III. SHPENZIME KAPITALE PËR VITIN 2025.

Fondet për shpenzime kapitale/Investime, të miratuar me ligjin vjetor nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit janë në masën 5 miliard e 304 milion lekë ose rreth 8% e fondeve të planifikuara në buxhetin 2025.

Sipas burimit të financimit, **4 miliard e 684 milion** ose **91.4%** e fondeve janë fonde me burim financimin e brendshëm dhe 620 milion lekë me burim financimin e huaj ose 11.6%.

- **Fondet e rishikuar me financim të brendshëm për vitin 2025, shtuar edhe** të ardhurat e autorizuarra për investimeve të IAL-ve publike arrijnë në shumën **5 miliard e 616 milion lekë** ose në 8% e fondeve të rishikuara për vitin 2025, per periudhën janar-gusht 2025.
- **Fondet e rishikuara në grupin e shpenzimeve kapitale** me financim të huaj, së bashku me të ardhurat e autorizuarra për investimeve arrijnë në shumën **400 milion lekë** osë 11% e fondeve të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2025,
- **Fondet për investime në grupin e shpenzimeve kapitale për 8 mujorin e vitit 2025 janë realizuar** në masën 2 miliard e 196 milion lekë ose 41,4% e planit, nga të cilat:
 - 1 miliard e 993 milion ose 35% janë investime të realizuara me financim të brendshëm;
 - 203 milion lekë është realizimi i investimeve me financim të huaj ose 3,6% e fondit total të investimeve ose 50,7% ndaj planit vjetor të rishikuar të investimeve me financim të huaj.

1. INVESTIMET_ARSIMI PARAUNIVERITAR_2025

Fondet për investime me financim të brendshëm në arsimin parauniversitar (ku përfshihet arsimi bazë si dhe arsimi i mesëm i lartë për vitin 2025) janë planifikuar në masën 2 miliard e 899 milion lekë ndërsa buxheti i rishikuar është në masën 2 miliard e 839 milion lekë. Prioritet mbetet finanimi i projekteve “Për ndërtime të reja dhe Rikonstruksione/ rindërtime”, bashkëfinancim i PPP Kontrata koncesionit Bashkia e Tiranës, produkte “Blerje pajisje laboratorizike, kimi, biologji”; “Blerje pajisje mobilie për shkollat e reja dhe të rehabilituara”, “Blerje pajisje mobilie për pajisjen e laboratorëve të SMATLAB-ve”, si dhe “Fonde për krijimin e fondi të bibliotekave shkollore”, sa vijon;

1. **Projekte “Për ndërtime të reja” dhe “Rikonstruksione”,** rindërtimin shtesa në objektet aktuale, ku parashikohen të financohen 2 miliard e 494 milion lekë për investime në **32 objekte arsimore me cikël financiar 2024-2025-2026**, si dhe **30 -32 projekte të reja me cikël financiar 2025-2026-2027** ku parashikohet të ndërtojmë rreth **650- 850 klasa dhe laboratorë mësimorë, ku** parashikohet të përfitojnë 8-12 mijë nxënës dhe 1200- 1500 mësues dhe edukatorë, financimi për vitin 2025 është **në masën 2 miliard 494 milion lekë** (pa përfshirë kontributet e njësive të vetëqeverisjes vendore), fondet e realizuara për 4-mujorin 2025 janë në masën 164.4 milion lekë .
2. **Bashkia Tiranë-Përmisimi i infrastrukturës arsimore** sipas kontratës Koncesionit nr.4907Rep; nr.1874Kol për Zonën Tirana 4”), si dhe financimi i PPP Kontrata koncesionit Bashkia e Tiranës nr.9513, date 17.10.2018 “**Përmirësimi i infrastrukturës arsimore, projektim, ndërtim, mobilim, mirëmbajtje, mbukqyrje, dhe kolaudim i 5 objekteve arsimore ne Zonën Tirana 1”**, për vitin 2025 janë parashikuar **për financim 350 milion lekë**. këto fonde janë kontraktuar me PPP dhe priten për tu realizuar nga njësitet e vetëqeverisjes vendore Bashkia Tiranës, realizimi i fondeve parashikohet brenda muajit qershor 2025.
3. **Për blerje “Pajisje mobilie për shkollat e reja dhe të rehabilituara”,** **fondi i parashikuar për vitin 2025 është në masën 180 milion lekë për** pajisjen me mobilie në arsimin parauniversitar, janë parashikuar **për financim 40-50 objekte shkollore** me rreth 650-700 klasa/laboratorë mësimorë, **ku** parashikohet të përfitojnë 10-12 mijë nxënës dhe 1200-1500 mësues dhe edukatorë, **fondi i rishikuar për vitin 2025 është 180 milion lekë për financim dhe pajisjen në 36 objekte shkollore**, këto fonde janë prokuruar nga MAS, për periudhën 4-mujore 2025 nuk ka realizim të fondeve.
4. **Për blerje “Pajisje laboratorizike_Kimi_Biologji”,** **fondi i parashikuar për vitin 2025 është në masën 198.8 milion lekë për** pajisjen me **laboratorë Fizikë_Kimi_Biologji** në arsimin parauniversitar, janë parashikuar **për pajisjen në 40-50 objekte shkollore** me rreth 650-700 klasa/laboratorë mësimorë, **ku** parashikohet të përfitojnë 10-12 mijë nxënës dhe 1200-1500 mësues dhe edukatorë, këto fonde janë prokuruar nga MAS, për periudhën 4-mujore 2025 realizimi i fondeve është në masën 44.9 milion lekë ose 22.6% e fondeve të miratuara për vitin 2025.
5. **Fonde për blerje librash “Për krijimin e fondi të bibliotekave shkollore”,** **fondi i parashikuar për vitin 2025 është në masën 25 milion lekë për** rritjen e mundësisë, aksesit të fëmijëve e sidomos të fëmijëve nga shtresat sociale në nevojë, ku parashikohet të përfitojnë

25000 nxënës dhe punonjës mësimorë të arsimit parauniversitar, plani i rishikuar për vitin 2025 është në masën 25 milion lekë, janë duke u realizuar procedurat e blerjes së përqëndruar, këto fonde janë parashikuar për tu realizuar në 4-mujorin e dytë 2025.

2.INVESTIME_ARSIMI I LARTË DHE KERKIMI SHKENCOR_2025

Fondet e miratuara për vitin 2025 për financimin e politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor janë në shumën totale 2,130 milion lekë (**1,480 milion lekë për arsimin e lartë dhe 650 milion lekë** për kërkimin shkencor).

Pas rishikimit të buxhetit, fondet janë 3,395 milion lekë (respektivisht **2,705 milion lekë** për arsimin e lartë dhe **690 milion lekë** për kërkimin shkencor).

Realizimi buxhetor për periudhën janar–gusht 2025 kap vlerën në total **1,127 milion lekë**, që përfaqëson **53 % të planit vjetor të rishikuar**.

Të detajuara sipas drejtimeve të financimit janë sa vijon;

1. UPT “Ndërtimi i Godinës së Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit”, Universiteti Politeknik i Tiranës, për vitin 2025 është financuar në masën 306.6 milion lekë, fondet e rishikuara janë në masën 306.6 milion lekë, për 8 mujorin e parë 2025 realizimi është 51,5 milion lekë.
2. UPT “Rikonstuksioni i Ndertesës së Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave +Ndërtimi i Muzeut të Gjeologjisë_UPT”, për vitin 2025 është financuar në masën 190 milion lekë, për 8 mujorin e parë 2025 realizimi është 73,4 milion lekë.
3. UD_Ndërtimi i godinës së Fakultetit të Studimeve Profesionale UAMD Durrës, për vitin 2025 është financuar në masën 202.5 milion lekë, fondi i rishikuar është në masën 202.5 milion lekë realizuar në masën 165,5 milion lekë ose rreth 82% e planit vjetor 2025.
4. Bashkia Tiranës në zbatim të Vendimit nr.641, datë 29.07.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e autoritetit kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit për objektet “Ndërtim i kampusit të ri të Universitetit të Tiranës”, Ndërtimi i Godinave të Universitetit të Arteve të Tiranës”, “Ndërtimi i Korpusit të Policisë së Shtetit, Policisë Shkencore dhe Akademisë së Sigurisë”, për vitin 2025 është financuar në masën 12.4 milion lekë, fondet e rishikuara janë në masën 12.4 milion lekë, realizimi i fondeve për vitin 2025 është në masën 12.4 milion lekë ose 100% e fondeve të miratuara për vitin 2025.
5. UE_ “UE_Ndërtimi i Godinës së Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike FSHMT- Universiteti Elbasan”, për vitin 2025 është financuar në masën 250 milion lekë, fondi i rishikuar është në masën 250. milion lekë, për 8 mujorin 2025 është 77,7 milion lekë.
6. US_”Rikonstrukcioni i fushës së futbollit, pistës së atletikës dhe rrethimi, Universiteti i Sporteve”, për vitin 2025 është financuar në masën 86.9 milion lekë, fondi i rishikuar është në masën 86.9 milion lekë, për 8 mujorin 2025 janë realizuar 15,2 milion lekë ose 17,4%.

Fondi me burim **Financimin e Huaj** “Granti i politikave të zhvillimit fondin për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike” është planifikuar 300 milion lekë, për financimin e 26 projekteve kërkimore dhe infrastrukturës akademike , fondet e rishikuara janë në masën 100 milion lekë, fondet janë realizuar në masën 17,2 milion lekë ose 17% e fondeve të rishikuara për vitin 2025.

Detajimi i investimeve për projektet e kërkimit shkencor jepet në rubrikën përkatëse të kërkimit shkencor.

3. “ZHVILLIMI I SPORTIT” (08140);

Financimi për vitin 2025 është **në masën 200 milion lekë** (FB) pa përfshirë kontributet e njësive të vetëqeverisjes vendore, fondet e rishikuara janë në masën 200 milion lekë për 5-7 objekte sportive, fondet për 8-mujorin 2025 nuk janë realizuar. Në këtë program financohen **projekte “Për ndërtim të reja” dhe “Rikonstruksione”, rindërtimin shtesa në objektet dhe mjediset e sportive aktuale** me cikël financimi 2024-2025-2026, ku parashikohet të përfitojnë 4-5 mijë nxënës dhe 400-500 mësues, Procedurat e prokurimit dhe realizimit për këto fonde janë duke u realizuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Fondi me burim financimin e huaj në këtë program janë planifikuar **20 milion lekë, për financimin e 3-5 projekteve**. Fondet e rishikuara janë në masën 0 lekë, janë pakësuar me Aktin Normativ nr.6 datë 11.06.2025.

4. “PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIM”, 01110:

Fondet për shpenzime kapitale për vitin 2025, janë miratuar 55 milion lekë, ose 5% e fondeve të këtij programi. Synim kryesor është përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve të infrastrukturës me qëllim përmirësimin e kushteve të punonjësve në institucione arsimore ku përfshihen Aparati i MAS, ASCAP, 5 DRAP si dhe 52 Zyrat Vendore Arsimore. Burimi financimit për investimet kapitale vitin 2025 është në masën 100% nga buxheti i shtetit. Fondet e rishikuara janë në masën 0 lekë, janë pakësuar me Aktin Normativ nr.6 datë 11.06.2025.

- Fondet e parashikuara për blerje pajisje orendi ”Pajisje të ndryshme - Aparati MAS” në shumën prej 10 milion lekë, Fondet e rishikuara janë në masën 10 milion lekë, fondet e rishikuara janë në masën 0 lekë, janë pakësuar me Aktin Normativ nr.6 datë 11.06.2025.
- Fondet e parashikuara për blerje pajisje orendi ” Blerje pajisje elektronike dhe softë informatike për shërbimet në MAS, DRAP/ZVA” në shumën prej 10 milion lekë. Fondet e rishikuara janë në masën 10 milion lekë, fondet e rishikuara janë në masën 0 lekë, janë pakësuar me Aktin Normativ nr.6 datë 11.06.2025.

Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 8 mujorin 2025:

1. **Procedura të shpërndarjes me vonesë të fondeve të miratuara për vitin 2025**, për shkak të lejimit të periudhës së pagesës për projektet e miratuara në vitin 2024 deri në fund të muajit janar 2025(Udhëzimi nr. datë i Ministrit të Financave);
2. **Vonesa në realizimin e procedurave të prokurimit në kohë** nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr. 9, datë 24.12.2020 , i ndryshuar me Vendimin nr. 16, datë 21.12.2024, për shkak të procesit elektoral në Republikën e Shqipërisë

3. Vonesa apo mosrealizim i procedurave të prokurimit nga **njësitë e vetëqeverisjes vendore** për fondet **ndërtimit dhe rindërtimit të objekteve arsimore** , për shkak të procesit elektoral në Republikën e Shqipërisë apo ankimimet ne Komisioneri i Prokurimit Publik;
4. **Vonesa në kryerjen e oponencave teknike te projekteve te ndërtim-rikonstruksionit nga autoritet shtetërore** (instituti i ndërtimit, etj) për disa nga projekte për investime në infrastrukturën arsimore 2025-2026;
5. **Shpërndarjen e fondeve grant për financimin e projekteve kërkimore shkencore**, si dhe financimin e pojekeve bilaterale për vitin 2025 nuk janë shpërndarë në kohë fondet grant për financimin e projekeve, për shkak të procesit elektoral në Republikën e Shqipëri

Detyrimet e prapambetura të akumuluar dhe krijuara rishtazi për periudhën Janar -30 Qershor 2025.

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.115/2024 ”Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, si dhe udhëzimit nr.5, datë 27.02.2014, të ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Shtojca 3, udhëzimit nr.37, datë 6.10.2020, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për monitorimin dhe publikimin periodik të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, **detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi dhe akumuluar deri më 30 Qershor 2025, të MAS** sipas njësive shpenzuese të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit paraqitet sa më poshtë:

Tab.1_Masa e detyrimeve të krijuara rishtazi dhe akumuluar deri më 30.06.2025

Ministria e Linjës	Detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi dhe akumuluar në fund të periudhës 30.06.2025						
	Gjendja në fillim të periudhës 1.01.2025		Detyrime të krijuara rishtazi deri 30.06.2025		Likuiduar deri 30.06.2025	Gjendja në fund të periudhës 30.06.2025	
	në lekë	në %	në lekë	në %	në lekë	në lekë	në %
Ministria e Arsimit dhe Sportit:	304,836	100	69,849,448	100	32,312,221	37,842,063	100
Institucione e arsimit parauniversitar (AKAP, DRAP, ZVA)	304,836	100	69,849,448	100	32,312,221	37,842,063	100
Institucione të tjera	0	0		0			0
IAL Publike	0	0		0			0

Për sa më sipër vihet re se:

- Detyrimet e krijuara rishtazi dhe akumuluar deri më 30 Qershor 2025, nuk janë raportuar për **institucionet publike të arsimit të lartë**, pasi bazuar në ligjin nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, IAL Publike gëzojnë autonomi financiare dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura realizohet me të ardhurat e krijuara nga këto institucione, duke mos rënduar buxhetin e shtetit.
- Detyrimet e krijuara rishtazi dhe akumuluar gjendje më 30 Qershor 2025, për njësitë shpenzuese të MAS, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre më fonde buxhetore, paraqiten në masën 70,154 mijë lekë, me ecuri sa më poshtë:
- Detyrime të akumuluar gjendje 01.01.2025 304 mijë lekë
 - Detyrime të krijuara rishtazi 6/mujori I 2025 69,8 milion lekë
 - Detyrime të likuiduara me fonde buxhetore 2025 32,3 milion lekë
 - Gjendja e detyrimeve në fund të periudhës 30.06.2025 37,8 milion lekë

Nga sa më sipër, vihet re në fund të periudhës raportuese deri më 30 Qershor 2025, detyrimet e prapambetura paraqiten në masën 37,4 milion lekë, e detajuar sipas njësive shpenzuese paraqitet sa më poshtë:

Tab. 2_ Masa e detyrimeve të prapambetura e detajuar sipas njësive shpenzuese të MAS për 6/mujori I 2025

Kodi Qeverisjes	Ministria e Linjës	Emri i Institucionit	Detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi dhe akumuluar deri në 30.06.2025						
			Gjendja në fillim të periudhës 1.01.2024		Detyrime të krijuara rishtazi deri 30.06.2025		Likuiduar deri 30.06.2025	Gjendja në fund të periudhës 30.06.2025	
			në leke	në %	në leke	në %	në leke	në leke	në %
1	11	Aparati i Ministrise se Arsimit	-	-	56,172,763	80	25,000,000	31,172,763	82%
1	11	Zyra Vendore Arsimore, Bulqizë	229,560	75	-	-	-	229,560	1%
1	11	Zyra Vendore Arsimore, Durrës	-	-	313,177	0	313,177	-	-
1	11	Zyra Vendore Arsimore, Kavaje	75,276	25	-	-	75,276	-	-
1	11	Zyra Vendore Arsimore, Kamez	-	-	2,532,149	4	-	2,532,149	7%
1	11	Zyra Vendore Arsimore, Fier	-	-	2,850,329	4	2,850,329	-	-
1	11	Zyra Vendore Arsimore, Krujë	-	-	31,883	0	31,883	-	-
1	11	Zyra Vendore Arsimore, Lezhë	-	-	563,700	1	563,700	-	-
1	11	Zyra Vendore Arsimore, Librazhd	-	-	393,200	1	393,200	-	-
1	11	Zyra Vendore Arsimore, Rrogozhinë	-	-	293,683	0	293,683	-	-
1	11	Zyra Vendore Arsimore, Tiranë	-	-	3,053,311	4	2,790,973	262,338	1%
1	11	Zyra Vendore Arsimore, Dibër	-	-	3,645,253	5		3,645,253	10%
		TOTALI	304,836	100	69,849,448	100	32,312,221	37,842,063	100%

Detyrimet e regjistrua nga Aparati i MAS, ZVA Tiranë, Zva Kamëz Zva Dibër, janë skeduluar për tu paguar brenda tremujorit të tretë të vitit 2025.

Duke analizuar historikun e detyrimeve të prapambetura, problematikat e situatës, shkakun dhe arsyen e pamundësisë për të shlyerjen në kohë të detyrimeve kontraktore dhe vendimeve gjyqësore të formës së prerë si rezultat i mungesës së fondeve buxhetore, detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi dhe akumuluar sipas natyrës së krijimit deri më 30 Qershor 2025, paraqiten sa më poshtë:

Tab 3_Detyrimet e prapambetura të akumuluar në fund të periudhës sipas natyrës së detyrimit deri më 30.06.2025

Nr.	Ministria e Linjës	Detyrimet e prapambetura të akumuluar në fund të periudhës sipas natyrës së detyrimit deri më 30.06.2025						
		Gjendja në fillim të periudhës 1.01.2024		Detyrime të krijuara rishtazi deri 30.06.2025		Likuiduar deri 30.06.2025	Gjendja e detyrimeve në fund të periudhës 30.06.2025	
		në leke	në %	në leke	në %	në leke	në leke	në %
	Totali i detyrimeve sipas natyrës së detyrimit:	304,826	100	69,849,448	100	32,312,221	37,842,053	100
1	Ekzekutim vendimeve gjyqësore të formës së prerë për largim nga puna	229,550	75	13,323,843	19	7,146,441	6,406,952	17
2	Ekzekutim vendimeve gjyqësore të formës së prerë	75,276	25	56,525,605	81	25,165,780	31,435,101	83

Sa më sipër vihet re se detyrimet e krijuara rishtazi dhe akumuluar deri më 30 Qershor 2025, janë detyrime që rrjedhin nga:

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë të cilat paraqiten:

- Akumuluar 01.01.2025	0,3 milion lekë
- Krijuar rishtazi në vitin 2025	69,8 milion lekë
- Likuiduar	32,8 milion lekë
- Detyrime në fund të 6-mujorit të parë 2025	37,8 milion lekë

Analize e detajuar e realizimit të produkteve sipas programeve buxhetore për periudhën Janar Gusht 2025 paraqitet s me poshtë;

1. Programi Buxhetor “Planifikim – Menaxhim” (01110)

Ky program synon krijimin e një sistemi të përshtatshëm, efektiv dhe eficient të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) në përputhje me standardet ligjore, përmes menaxhimit me bazë performance, duke rritur efikasitetin në përdorimin e burimeve financiare dhe materiale në arsim, si dhe efektivitetin në përdorimin e burimeve njerëzore.

Nëpërmjet këtij programi synohet:

- Rritja e kapaciteteve dhe aftësive menaxhuese në të gjitha nivelet — qendror (MAS), rajonal (DRAP/ZVAP) dhe lokal (institucionet arsimore);
- Vendosja e mekanizmave transparente të monitorimit dhe llogaridhënies;
- Përgatitja e akteve ligjore e nënligjore të sistemit arsimor në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe zhvillimet bashkëkohore;
- Implementimi i strategjive kombëtare në arsim.

Objektivat Kryesore të programit

- **Objektivi 1**
Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese për **15 % të punonjësve** të MAS, njësive arsimore vendore dhe institucioneve arsimore — për **110–120 punonjës**, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.
- **Objektivi 2**
Krijimi i një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të MFK-së në përputhje me standardet ligjore, përgatitja e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe **përmirësimi i standardeve të punës** përmes:
 - rinovimit të pajisjeve elektronike, teknologjike dhe mobilierisë;
 - rindërtimit të **10 % të godinave** çdo vit.
- **Objektivi 3**
Vlerësimi i cilësisë së shërbimit arsimor mbi bazën e treguesve të performancës, nëpërmjet **ndërtimit të një sistemi të qëndrueshëm e transparent monitorimi**, në planifikimin dhe përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe materiale.
- **Objektivi 4**
Auditimi në masën **20–25 %** të institucioneve vendore arsimore dhe **inspektimi në masën 10–12 %** të institucioneve arsimore në APU, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.
- **Objektivi 5**
Trajnimi çdo vit i **100–120 drejtuesve të institucioneve arsimore** në APU, për realizimin e **autonomisë së institucioneve arsimore** dhe fuqizimin e kapaciteteve planifikuese e menaxhuese në nivel shkolle, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.

Treguesit Financiarë 2025	Vlera në milion lekë	% ndaj totalit të programit	Shënime
Fonde të miratuara	1,150.2	100 %	
– Shpenzime korente	1,095.2	95.2 %	Pagat + funksionimi
– Shpenzime kapitale	55.0	4.8 %	Investime, pajisje
Fonde të rishikuara	1,101.0	—	Pas rishpërndarjes
Realizimi 8-mujor 2025	664.1	60 %	

- Fonde të programit ndaj **totalit të fondeve për arsim: 1.8 %**
- Fonde të programit ndaj **PBB-së: 0.05 %**
- Fonde të programit ndaj **shpenzimeve publike: 0.17 %**
- Realizimi 8-mujor përbën **1.6 % të shpenzimeve të realizuara për arsimin** në 2025.

Realizimi i fondeve për periudhën **Janar–Gusht 2025** është në masën **60 % ndaj planit 8-mujor**, i ndikuar kryesisht nga:

- mosplotësimi i plotë i vendeve vakante në strukturat e miratuara;
- vonesa në procedurat e prokurimeve publike për blerje pajisjesh dhe investime;
- aktet normative që kanë ulur fondet kapitale në 0 lekë në qershor 2025.

Tabela nr. 1_ Fondet e miratuar me ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, në lekë per programin 01110

Kodi i Progr	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 230	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 604	Art. 605	Art. 606	Total
	Te ardhura jashtë limiti		Shp. Faktike					3,688,430				3,688,430
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Plani fillestar	-	55,000,000	853,768,000	130,411,000	110,301,000	0	0	720,000	1,150,200,000
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Plani i rishikuar	-		853,768,000	130,411,000	113,089,430	0	0	4,261,876	1,101,530,306
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Shpenzime faktike	-	0	516,013,268	85,108,491	60,066,085	0	0	2,999,955	664,187,800
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Angazhime	-	0	0	0	5,205,058	0	0	0	5,205,058
	Ndryshimi ne vlere absolute	2025		-	-	337,754,732	45,302,509	47,818,287	-	-	1,261,921	432,137,448
	Realizimi ne %	2025		-	0	60%	65%	53%			70%	60%

Për vitin 2025, në programin “01110 – Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, fondet e miratuara në zërin Pagat dhe sigurimet shoqërore (artikujt 600–601) arrijnë në 984.2 milion lekë.

Fondet e rishikuara mbeten në të njëjtën shumë — 984.2 milion lekë, që përfaqëson 85.6 % të fondeve të miratuara për vitin 2025.

Realizimi për periudhën janar–gusht 2025 është në masën 664.1 milion lekë, ose 60 % ndaj fondit të planifikuar për 8-mujorin. Këto fonde kanë mbuluar pagat dhe sigurimet shoqërore për gjithsej 619 punonjës, të shpërndarë si më poshtë:

- Aparati i MAS – 131 punonjës (sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 215, datë 13.12.2023 dhe Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021);
- Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) – 33 punonjës;
- 5 DRAP – 115 punonjës gjithsej;
- 52 ZVAP – 340 punonjës gjithsej.

Planifikimi dhe miratimi i fondeve për “Shpenzime personeli” është bërë në përputhje me:

- VKM nr. 325, datë 31.5.2023, e ndryshuar — për strukturën dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve të administratës qendrore;
- VKM nr. 422, datë 26.6.2024, për shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 326, datë 31.5.2023 — për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

Shpenzimet Korente për funksionim (Art. 602–605)

Për vitin 2025 janë planifikuar 112.7 milion lekë për krijimin e kushteve të punës për rreth 619 punonjës, ose 9.8 % të fondeve totale të miratuara për programin. Këto fonde janë përdorur për shpenzime të tilla si:

- energji elektrike, telefon, internet, ujë;
- karburant, udhëtime e dieta;
- kancelari, materiale dhe shërbime të tjera zyre;
- shlyerje detyrimesh gjyqësore të formës së prerë;
- trajnime për stafin e MAS, DRAP, ZVAP (EMIS, drejtorë shkollash, prokurime, buxhet/investime, etj.).

Realizimi për 8-mujorin 2025 është 64 milion lekë, ose 54 % ndaj fondit të rishikuar. Nga këto, 1.3 milion lekë janë përdorur për shpërblime të menjëhershme dhe për dalje në pension të punonjësve.

Shpenzimet Kapitale/Investimet

Për vitin 2025 janë miratuar 55 milion lekë për investime kapitale (rreth 5 % e totalit të programit), me synim përmirësimin e infrastrukturës për Aparatin e MAS, ASCAP, 5 DRAP dhe 52 ZVAP. Burimi i financimit është 100 % nga buxheti i shtetit.

Fondet e rishikuara janë në të njëjtën masë, por nuk është realizuar asnjë shpenzim kapital, pasi fondet janë pakësuar me Aktin Normativ nr. 6, datë 11.06.2025.

- Blerje pajisje/orendi për Aparatin e MAS – planifikuar 10 milion lekë → rishikuar në 0 lekë pas AN nr. 6;
- Blerje pajisje elektronike dhe softëare për MAS, DRAP/ZVAP – planifikuar 10 milion lekë → rishikuar në 0 lekë pas AN nr. 6.

Fondi për pajisje elektronike në vlerën 45 milion lekë është dërguar për prokurim në AKSHI, por procedurat nuk janë finalizuar deri në fund të periudhës 8-mujore dhe janë pakësuar me Aktin Normativ nr. 6, datë 11.06.2025

Treguesit e Realizimit të buxhetit për 8-mujorin 2025

Kategori	Realizimi (%)
Shpenzime korente	60 %
Shpenzime kapitale	0 %
Gjithsej programi	60 %

Ky nivel realizimi përfaqëson 1.8 % të totalit të shpenzimeve të realizuara të MAS për vitin 2025.

Faktorët që kanë ndikuar në nivelin e realizimit të buxhetit për periudhën 8-mujore 2025:

- Vendet vakante – mosplotësimi i rreth 5 % të numrit të miratuar të punonjësve (13–15 pozicione vakante në Aparatin e MAS; 30–35 pozicione vakante në MAS, AKAP, DRAP dhe ZVAP).
- Procedurat e zgjatura të prokurimit publik, veçanërisht për pajisje IT, kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve kapitale.
- Aktet normative të Qershorit 2025 kanë sjellë ulje të fondeve kapitale në 0 lekë.

Periudha e Raportimit 8-2025														
Emri i	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi			Kodi i programit		01110								
EMËRTIME				Shpenzimet e Programit										
				Viti paraardhës2024		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudh/raportu	Periudha raportuese			
				Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzi në %	Plani Fillestar	Struktura e shpenz në %	Plani Vjetor	Struktura e shpenzi	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenz Faktike të Periudhës/Prog	Struktura e shpenzim në %	Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
						Vjetor		i Rishikuar						
						Viti 2025		Viti 2025						
-1	-2	-3	-4	-5	-6	7 (5-3)	-8	-9	10 (5-8)	11 (8/5)				
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik														
600	Paga	724,839,301	30	853,768,000	30	853,768,000	100%	0	516,013,268	30	337,754,732	60%		
601	Sigurime Shoqërore	118,734,346	33	130,411,000	33	130,411,000	100%	0	85,108,491	33	45,302,509	65%		
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	103,162,037	27	110,301,000	27	113,089,430	103%	0	60,066,085	27	53,023,345	53%		
603	Subvencione	0	0	0	0	0		0	0	0	0			
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0	0		0	0	0	0			
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0		0	0	0	0			
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	3,981,229	72	720,000	72	4,261,876	592%	3,541,876	2,999,955	72	1,261,921	70%		
	Nëntotali Shpenzime Korente	950,716,914	30	1,095,200,000	30	1,101,530,306		6,330,306	664,187,799		437,342,507	60%		
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0			
231	Kapitale të Trupëzuara	22,238,160	0	55,000,000	0		0	0	0	0	0			
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	22,238,160	0	55,000,000	0		0	0	0	0	0			
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0			
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Totali i Shpenzimeve Kapitale	22,238,160	0	55,000,000	0		0	0	0	0	0			
	Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit	972,956,724	29	1,150,200,000	29	1,101,530,306	29	1,641,876	664,187,799	29	437,342,507	60%		
	Shpenzime Korente nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	2,100,000							0		0			
	Shpenzime Kapitale nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0							0		0			
	Totali i Shpenzimeve të Programit	975,056,724							664,187,799		- 664,187,799			
	Totali i Shpenzime Korente	950,716,914	98	1,095,200,000	95	1,101,530,306	100%	1,641,876	664,187,799	100	437,342,507	60%		
Kod prod	Emertimi										0			
91101AA	Punonjës dhe specialistëve të trajnuar,	17,329,320	2	12,221,000	1	12,221,000	1	0	5,093,326	1	7,127,674	42%		
91101AB	Institucioneve te audituara dhe inspektuara	9,074,987	1	9,100,000	1	9,100,000	1	0	4,401,895	1	4,698,105	48%		
91101AC	Drejtuesve të institucioneve arsimore te trajnuar.	4,400	0	8,000,000	1	8,000,000	1	0		0	8,000,000	0%		
91101AD	Akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara dhe miratuara.	30,489,460	3	30,000,000	3	32,788,430	3	0	25,012,974	3	7,775,456	76%		

91101AE	Veprimtari e MASR sipas kerkesave ligjore	893,818,747	92	1,035,879,000	90	1,039,420,876	90	1,641,876	629,679,605	95	409,741,271	61%
91101AE	Veprimtari e MASR sipas kerkesave ligjore	1,650	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
	Totali Shpenzime për Investime	22,238,160	2	55,000,000	5		5	0	0	0	0	
M112408	Pajisje te ndryshme - Aparati MASH	0	0	10,000,000	1		1	0	0	0	0	
M112542	Blerje pajisje elektronike dhe softje informatike per sherbimet ne MAS,	22,238,160	2	10,000,000	1		1	0	0	0	0	
M112684	Rikonstruksione te zyrave te DAR/ZA	0	0	35,000,000	3		3	0	0	0	0	
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	22,238,160	2	55,000,000	5		5	0	0	0	0	
	Emertimi										0	
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
	Total Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit (Kap 06)	2,100,000	100						0	0	0	
	Shpenzime korente nga të ardhurat jashtë limitit (Kap 06)	2,100,000	100						0	0	0	
	Emertimi										0	
91101AA	Punonjës dhe specialistëve të trajnuar,	2,100,000	100						0	0	0	
	Emertimi										0	
	Totali i Shpenzimeve të Programit	975,056,724		1,150,200,000		1,101,530,306		1,641,876	664,187,800		437,342,506	60%

Objektivi 2) i programit (01110)

Krijimi i një sistemi të përshtatshëm, efektiv dhe eficient të MFK-së konform standardeve ligjore; përgatitja e akteve ligjore dhe nënligjore për zbatimin e planeve strategjike të arsimit; energjizimi dhe rritja e përdorimit me eficiencë e efektivitet të burimeve njerëzore.

Rezultatet e realizuara Janar–Gusht 2025

Në mbështetje të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore përkatëse (VKM nr. 125, nr. 124 dhe nr. 243), **Drejtoria e Burimeve Njerëzore** ka realizuar një sërë aktivitete që lidhen me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në shërbimin civil dhe në institucionet e varësisë.

Gjatë periudhës raportuese janë kryer:

1. Rekrutime dhe Lëvizje në Shërbimin Civil

- Procedurat për **3 pozicione vakante** në shërbimin civil në Aparatin e MAS, në bashkëpunim me DAP;
- **3 procedura rekrutimi** të finalizuara, të gjitha për pranime në kategorinë ekzekutive;
- **1 praktikë** për transferim në institucionet e varësisë;
- **1 praktikë pezullim statusi** nga shërbimi civil;
- **1 praktikë ndërprerje marrëdhëniesh pune** për shkak të emërimit në institucion tjetër (ngritje në detyrë);
- **2 praktika** konfirmimi në shërbimin civil, pas periudhës njëvjeçare të provës.

2. Administrim Marrëdhëniesh Pune dhe Emërime

- **6 shkresa** për fillimin/përfundimin e marrëdhëniesh financiare të punonjësve (emërime, transferime, pezullime, lirime);
- **8 praktika** për emërime/lirime në pozicione administrative dhe politike (4 emërime + 4 lirime);
- **6 kontrata pune 1-vjeçare** të lidhura dhe **1 kontratë e zgjidhur** sipas VKM nr. 19, datë 09.01.2025, për punonjësit me kontratë të përkohshme në administratën qendrore.

3. Përfaqësime, Bordet dhe Praktikant

- Në zbatim të VKM nr. 782, datë 26.12.2018 dhe urdhrit nr. 687, datë 14.12.2023, është realizuar **1 praktikë përzgjedhjeje** për anëtar bordi administrimi – përfaqësues i studentëve në IAL.
- **15 kontrata 1-vjeçare** janë përgatitur dhe nënshkruar për praktikantë në kuadër të **Thirrjes IX të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës**.

4. Ankesa, Procedura Ligjore dhe Raportime

- Është trajtuar dhe kthyer përgjigje për **1 ankesë** pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Është kryer përfaqësim në **1 seancë dëgjimore** dhe në **2 seanca** për ankesa të vitit 2024;
- Janë hartuar **5 raporte** për IAL-të lidhur me verifikimin e kritereve të ligjshmërisë.

5. Procedura për Oficerë Sigurie në APU

- Në zbatim të Urdhrit nr. 593, datë 06.12.2024, është përgatitur praktika për Akademinë e Sigurisë dhe urdhri i psikologut për intervistimin e **105 kandidatëve të kualifikuar**, për trajnimin, testimin dhe certifikimin e tyre si oficerë sigurie në institucionet arsimore parauniversitare publike.

6. Përditësim i të Dhënave dhe Praktika Administrative

- Është kryer **shtimi/ndryshimi/plotësimi i të dhënave për 29 punonjës të MAS** (shërbimi civil, administrativë, kontratë, praktikantë);
- Është shqyrtuar një volum i konsiderueshëm prej **192 praktikash të ardhura nga institucione dhe qytetarë**.

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar (DBMF) ka realizuar produktet dhe rezultatet

Rezultatet Janar–Gusht 2025

- Miratimi, shpërndarja dhe ndjekja e zbatimit të fondeve 2025 (Ligji nr. 115/2024). Shkresa për MFE: nr. 8208/1, datë 31.12.2024.
- Shpërndarja e fondeve 2025–2027 për të gjitha institucionet e sistemit të MAS. Miratimi nga MFE: nr. 17548/98, datë 20.01.2025. Shkresa për institucionet e varësisë: nr. 8208/3, datë 24.01.2025.
- Limitet mujore të shpenzimeve 2025 për të gjitha institucionet. Miratimi nga MFE: nr. 17548/143, datë 24.01.2025.
- Hartimi dhe shpërndarja e fondeve të investimeve 2025–2027. Shkresat për MFE: nr. 685/1, datë 30.01.2025; nr. 835/1, datë 06.02.2025. Miratimi nga MFE: nr. 2779, datë 12.03.2025.
- Plani i shpenzimeve në valutë 2025 për institucionet arsimore. Shkresa për MFE: nr. 373/15, datë 01.02.2025.
- Raportim për detyrimet/borxhet e krijuara rishtazi – tremujori I 2024. Shkresa për MFE: nr. 2344/5, datë 15.04.2025.
- Deklarata Vjetore “Për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm” për vitin 2024. Shkresa për MFE: nr. 1524/1, datë 29.02.2024.
- Pyetësi i vetëvlerësimit 2024 sipas MFK (neni 19 i Ligjit nr. 10296). Shkresa për MFE: nr. 1524/2, datë 29.02.2024.
- Raporti i risqeve fiskale 2025. Shkresa për MFE: nr. 2479/1, datë 15.04.2024.
- Raporti i monitorimit të konsoliduar – 4-mujori i parë 2025 (AFMIS), me anekse. Shkresa për MFE: nr. 3379, datë 30.05.2025.
- Raportim për detyrimet e zbatimit të vendimeve gjyqësore (jan–dhj 2024). Shkresa për MFE: nr. 625/45, datë 13.02.2025.
- Pasqyrat Financiare Vjetore të konsoliduara – 2024. Shkresa për MFE: nr. 2015/85, datë 30.04.2024.
- Ekspertizë buxhet–financa për Kapitujt 25 & 26 të Acquis; kontribute në KSA, inovacion, TIK, politika sociale; zbatim i rekomandimeve afatshkurtra të KE.

- Raportime valutore 2024 dhe TM1 2025 për institucionet arsimore. Shkresa për MFE: nr. 920/4, datë 20.02.2025; nr. 2344/6, datë 15.04.2025.
- Autorizime udhëtimesh & dietash 2025 sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.
- Autorizime për pagesa nga fondi i veçantë 2025 sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.
- Pjesëmarrje në grupe pune 2025 për projekt-akte ligjore/nënligjore në arsimin parauniversitar dhe të lartë (komponenti financiar) sipas Matricës së akteve 2025.
- Planifikim, ndjekje dhe raportim mujor i projekteve me financim të huaj (kosto lokale dhe TVSH), në zbatim të Planit Vjetor të Reformës.
- Kontributi i Qeverisë Shqiptare për Progres-Raportin – Kap. 26 & 25 (pjesa e fondeve në arsim).
- Kontributi i III-të për Progres-Raportin (prill 2025) – Kap. 26 & 25 (fondet në arsim).
- Kontribute për MFE/Drejtorinë e Integritetit në nën-komitete/komitete (Çështje Ekonomike & Financiare, KSA, Inovacion, Shoqëria e Informacionit, Politikat Sociale) dhe përgjigje për rekomandimet e KE.
- Monitorime analitike: personeli/pagat, transporti nxënësve & mësuesve, bursa & kuota ushqimore, tekstet & kompensimet, investimet kapitale, problematika në IAL publike.
- Pjesëmarrje në grupe pune në MAS për projekt-vendime, projekt-udhëzime, projekt-urdhra dhe akte të tjera nënligjore të reformës.
- Rishpërndarje fondesh për buxhetin 2025 (Ligji nr. 115/2024).
- Specifikime teknike dhe fonde limit për procedura të prokurimit publik 2025.
- Ndjekja e detyrimeve të prapambetura (Ligji nr. 48/2014; VKM nr. 50, 05.02.2014; Udhëzimi nr. 5, 27.02.2014): analiza periodike dhe raportime – raport 6-mujor 2025.
- Dosja analitike e detyrimeve të prapambetura: historik, shkaqe/massa; detyrime deri më 31.03.2025; likuidime deri më 30.06.2025; plani i shlyerjes 2025 & 2025–2027.
- **PBA Faza II (2026–2028)**: koordinim me ekipet e menaxhimit të programeve; kostimi i politikave të reja të PBA 2026-2028
- Monitorim performancash: procedura të titullarëve/NA/Zbatuesve/Drejtuesve; raportim mbi realizimin e buxhetit, produkteve, indikatorëve & standardeve të PBA.

Referencë: MAS – Buxheti dhe Financat (arsimi.gov.al/buxheti-dhe-financat).

Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin (DPRAS) ka realizuar produktet dhe rezultatet

Rezultatet e realizuara Janar–Gusht 2025

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar” – në proces diskutimi në komisionet parlamentare.

- Vendime të Këshillit të Ministrave

- 1) Vendimi nr. 108, datë 19.02.2025 – Marrëveshja e bashkëpunimit me Qeverinë e Kosovës për Lojërat Mesdhetare, Prishtina 2030.
- 2) Vendimi nr. 98, datë 12.02.2025 – Miratimi në parim CEFTA (njohja e kualifikimeve profesionale), bashkëpropozim me MEKI.
- 3) Vendimi nr. 151, datë 06.03.2025 – Masa të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës on-line “TikTok”, bashkëpropozim me MIE, MD, MB, MSHMS.
- 4) Vendimi nr. 147, datë 06.03.2025 – Shtesë fondi 2025 për këstin e dytë të kontratës për “Giro d’Italia 2025” në Shqipëri.
- 5) Vendimi nr. 148, datë 06.03.2025 – Shtesa në VKM nr. 104, datë 28.02.2019 (Regjistri shtetëror i mësuesve të gjuhës dhe kulturës shqiptare; Diaspora). (PPAP katërmujori I)
- 6) Vendimi nr. 198, datë 04.04.2025 – Ndryshime/shtesa në VKM nr. 135, datë 06.03.2024 (shtetësia për interes kombëtar/arsim, shkencë, art, kulturë, sport), bashkëpropozim me MB & MEKI.
- 7) Vendimi nr. 201, datë 04.04.2025 – Ndryshime në VKM nr. 440, datë 19.07.2023 (skema e kreditimit studentor). (PPAP katërmujori I)
- 8) Vendimi nr. 227, datë 17.04.2025 – Ndryshime/shtesa në VKM nr. 600, datë 09.10.2018 (shërbimi i sigurisë publike në APU; kriteret për oficerët e sigurisë). (PPAP katërmujori II)
- 9) Vendimi nr. 239, datë 24.04.2025 – Ndryshime/shtesa në VKM nr. 119, datë 01.03.2023 (transporti i punonjësve arsimorë dhe nxënësve jashtë vendbanimit). (PPAP katërmujori I)
- 10) Vendimi nr. 249, datë 30.04.2025 – Ndryshime në VKM nr. 742, datë 03.12.2021 (baza e të dhënave shtetërore e SMIP). (PPAP katërmujori II)

- Udhëzime të MAS 2025

- 1) Udhëzim nr. 1, datë 09.01.2025 – Matura Shtetërore & Matura Profesionale 2025.
- 2) Udhëzim nr. 2, datë 21.01.2025 – Ndryshime/shtesa në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 (procedura AL).
- 3) Udhëzim nr. 3, datë 21.01.2025 – Ndryshime/shtesa në Udhëzimin nr. 29, datë 18.12.2019 (regjistrat e gradave/titujve).
- 4) Udhëzim nr. 4, datë 21.01.2025 – Shtesë/ndryshim në Udhëzimin nr. 6, datë 19.02.2018 (numrat e matrikullimit).
- 5) Udhëzim nr. 5, datë 21.01.2025 – Ndryshime/shtesa në Udhëzimin nr. 10, datë 30.03.2020 (diplomat/certifikatat në AL).
- 6) Udhëzim nr. 6, datë 21.01.2025 – Ndryshime/shtesa në Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 (kualifikimi i punonjësve arsimorë).
- 7) Udhëzim nr. 7, datë 21.01.2025 – Ndryshime/shtesa në Udhëzimin nr. 13, datë 30.06.2023 (njëvlershmëria e dëftesave/diplomave të ardhura nga jashtë).
- 8) Udhëzim nr. 8, datë 21.01.2025 – Ndryshime/shtesa në Udhëzimin nr. 10, datë 03.04.2015 (licenca e mësuesit).
- 9) Udhëzim nr. 9, datë 24.01.2025 – Ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 13.03.2017 (QSHA).
- 10) Udhëzim nr. 10, datë 27.01.2025 – Provimet kombëtare të arsimit bazë, 2024–2025.
- 11) Udhëzim nr. 11, datë 07.02.2025 – Vlerësimi i arritjeve në arsimin fillor, 2024–2025.
- 12) Udhëzim nr. 12, datë 24.02.2025 – Ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 (kualifikimi i punonjësve arsimorë).
- 13) Udhëzim nr. 13, datë 07.03.2025 – Ndryshime/shtesë në Udhëzimin nr. 16, datë 08.07.2019 (regjistrat AL).

- 14) Udhëzim nr. 14, datë 13.03.2025 – Shtesë në Udhëzimin nr. 8, datë 03.05.2024 (portal “Mësues për Shqipërinë”).
- 15) Udhëzim nr. 15, datë 13.03.2025 – Shtesa në Udhëzimin nr. 25, datë 25.07.2018 (Bordi i institucionit arsimor).
- 16) Udhëzim nr. 16, datë 17.04.2025 – Programi CEEPUS IV në Republikën e Shqipërisë.

Për 4-mujorin e dytë 2025 janë iniciuar 5 projektakte;

- a. Plani i Veprimit të Arsimit Digjital 2025–2030 (standardet e kompetencës digjitale) – Urdhri nr. 5, datë 09.01.2025; publikuar në RENJK më 04.08.2025 (afati komente 01.09.2025). Në pritje të mendimit të MEI; reflektuar komentet e MFE; në përgatitje për ribashkërendim.
- b. Ndryshime në VKM nr. 742, datë 03.12.2021 (SMIP) – Urdhri nr. 5, datë 09.01.2025. Status: Miratuar me VKM nr. 249, datë 30.04.2025.
- c. Ndryshime në VKM nr. 607, datë 31.08.2016 (AKKSHI) – Urdhri nr. 5, datë 09.01.2025. Status: Miratuar me VKM nr. 464, datë 31.07.2025.
- d. Ndryshime në VKM nr. 450, datë 30.06.2021 (përgjashtime doganore/TVSH për materiale dhe pajisje sportive). Status: Dërguar për miratim në KM më 29.07.2025.
- e. Ndryshime në VKM nr. 600, datë 09.10.2018 (shërbimi i sigurisë publike në APU; kriteret për oficerët e sigurisë) – Urdhri nr. 5, datë 09.01.2025. Status: Miratuar me VKM nr. 227, datë 17.04.2025.

Projektaktet e miratuara dhe në proces jashtë PPAP

- KM – Marrëveshja me Kosovën për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030. Status: Miratuar me VKM nr. 108, datë 19.02.2025.
- KM – CEFTA (njohja e kualifikimeve profesionale) – bashkëpropozim me MEKI. Status: Miratuar me VKM nr. 98, datë 12.02.2025.
- KM – Masa të përkohshme për “TikTok”. Status: Miratuar me VKM nr. 151, datë 06.03.2025.
- KM – Shtesë fondi për “Giro d’Italia 2025”. Status: Miratuar me VKM nr. 147, datë 06.03.2025.
- KM – Ndryshime/shtesa në VKM nr. 135, datë 06.03.2024 (shtetësia me interes kombëtar), bashkëpropozim MB, MAS, MEKI. Status: Miratuar me VKM nr. 198, datë 04.04.2025.
- KM – Ndryshim në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (elementet e programeve të studimit në AL). Status: Miratuar me VKM nr. 282, datë 21.05.2025.
- KM – Financimi i FA “Durrah City Football Academy” 2025. Status: Miratuar me VKM nr. 303, datë 28.05.2025.
- KM – Marrëveshja “Për akses në arsimin e lartë në Ballkanin Perëndimor”. Status: Miratuar me VKM nr. 314, datë 04.06.2025.
- KM – Ndryshime në VKM nr. 109, datë 15.02.2017 (ASCAL/BA; tarifat). Status: Praktika dërguar për mendim – MD me komente, MF dakord; MAS vendosi mosprocedimin.
- KM – Ndryshime në VKM nr. 893, datë 27.12.2022 (“Ekipet sportive në shkolla”, KOKSH). Status: Miratuar me VKM nr. 424, datë 23.07.2025.
- KM – Financimi i Federatës Shqiptare të Skive për Milano Cortina 2026. Status: Miratuar me VKM nr. 423, datë 23.07.2025.
- KM – AKPT si organ qendror blerës për konkursin e projektimit të Kampusit “Aleksandër Moisiu” Durrës & shtesë fondi për AKPT. Status: Dërguar për miratim në KM.

- KM – Heqja e masave të përkohshme për “TikTok”. Status: Praktika e kthyer në sistem nga KM.

Aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 109/2024 (1–13)

- VKM – KKSHKSH (organizim, funksionim, lirime). Status: Miratuar me VKM nr. 304, datë 28.05.2025.
- Standardet & kriteret e Shkencës së Hapur (ERA). Status: Dërguar për mendim më 25.07.2025 (MD/MF/MSK); MF me komente; MD dakord me sugjerim; MSK dakord – në reflektim.
- Modeli i financimit të buxhetit për shkencën dhe kërkimin – në proces (draft paraprak nga Drejtoria Juridike).
- Kodi i Etikës në Shkencë & Kërkim – finalizuar nga grupi i punës (në reflektim të sugjerimeve të ASH).
- Kriteret & procedurat për institutet/jësitë e veçanta (krijim, mbikëqyrje, pezullim, mbyllje) – dërguar për mendim më 11.07.2025; komente nga MF, MM, MAPA – në reflektim dhe ribashkërendim.
- Regjistri Kombëtar i institucioneve/unikateve/kërkuesve (formë, përmbajtje, elementë; procedura & dokumentacion) – në proces hartimi.
- Fushat me rëndësi të veçantë të kërkimit (leje e veprimtarisë; kriteret/procedura) – në proces hartimi.
- Metodologjia e vlerësimit të kushteve të funksionimit të instituteve & njësive të veçanta që financohen publikisht – në proces hartimi.
- Statusi “Qendër Ekselence” – kriteret dhe procedura – në proces hartimi.
- Pagat, kategorizimet dhe shpërblymimi i personelit kërkimor publik sipas cilësisë/relevancës së rezultateve – në proces hartimi.
- Kriteret/procedurat për përfitimin e kategorisë nga punonjësit kërkimorë–shkencorë – dërguar për mendim më 11.07.2025; MD & MF dakord me komente – në reflektim dhe ribashkërendim.
- Projektudhëzim – kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore–shkencore – në proces hartimi.
- Projektudhëzim – financimi konkurrues i programeve/projekteve kërkimore (IAL, institute me ligj të posaçëm, jopublike) – në proces hartimi.

Vendime të Këshillit të Ministrave 2025 – informim (14–30)

- 1) VKM nr. 108, datë 19.02.2025 – Marrëveshja me Kosovën për Lojërat Mesdhetare (jashtë PPAP).
- 2) VKM nr. 98, datë 12.02.2025 – CEFTA/MEKI (jashtë PPAP).
- 3) VKM nr. 151, datë 06.03.2025 – Masa të përkohshme “TikTok” (jashtë PPAP).
- 4) VKM nr. 147, datë 06.03.2025 – Shtesë fondi “Giro d’Italia 2025” (jashtë PPAP).
- 5) VKM nr. 148, datë 06.03.2025 – Regjistri i mësuesve në Diasporë (PPAP I).
- 6) VKM nr. 198, datë 04.04.2025 – Shtetësia për interes kombëtar (jashtë PPAP).
- 7) VKM nr. 201, datë 04.04.2025 – Skema e kreditimit studentor (PPAP I).
- 8) VKM nr. 227, datë 17.04.2025 – Shërbimi i sigurisë publike në APU (PPAP II).
- 9) VKM nr. 239, datë 24.04.2025 – Transporti i punonjësve/nxënësve jashtë vendbanimit (PPAP I).
- 10) VKM nr. 249, datë 30.04.2025 – SMIP – baza e të dhënave shtetërore (PPAP II).
- 11) VKM nr. 282, datë 21.05.2025 – Elementet e programeve të studimit në AL (jashtë PPAP).

- 12) VKM nr. 303, datë 28.05.2025 – Financimi i “Durrah City Football Academy” 2025 (jashtë PPAP).
- 13) VKM nr. 304, datë 28.05.2025 – KKSHKSH (organizim, funksionim, lirime) (jashtë PPAP).
- 14) VKM nr. 314, datë 04.06.2025 – Qasje në AL & pranimi për të studiuar në BP (jashtë PPAP).
- 15) VKM nr. 423, datë 23.07.2025 – Financimi i Federatës Shqiptare të Skive (jashtë PPAP).
- 16) VKM nr. 424, datë 23.07.2025 – “Ekipet sportive në shkollë”/KOKSH (jashtë PPAP).
- 17) VKM nr. 464, datë 31.07.2025 – Ndryshime/shtesa në VKM nr. 607/2016 (AKKSHI) (PPAP I

Udhëzimet e miratuara të MAS 2025 (31–53)

- 1) Udhëzim nr. 1, datë 09.01.2025 – Matura Shtetërore & Profesionale 2025.
- 2) Udhëzim nr. 2, datë 21.01.2025 – Ndryshime/shtesa në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 (procedura AL).
- 3) Udhëzim nr. 3, datë 21.01.2025 – Ndryshime/shtesa në Udhëzimin nr. 29, datë 18.12.2019 (regjistrat e gradave/titujve).
- 4) Udhëzim nr. 4, datë 21.01.2025 – Shtesë/ndryshim në Udhëzimin nr. 6, datë 19.02.2018 (numrat e matrikullimit).
- 5) Udhëzim nr. 5, datë 21.01.2025 – Ndryshime/shtesa në Udhëzimin nr. 10, datë 30.03.2020 (diplomat/certifikatat).
- 6) Udhëzim nr. 6, datë 21.01.2025 – Ndryshime/shtesa në Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 (kualifikimi).
- 7) Udhëzim nr. 7, datë 21.01.2025 – Ndryshime/shtesa në Udhëzimin nr. 13, datë 30.06.2023 (njëvlershmëria).
- 8) Udhëzim nr. 8, datë 21.01.2025 – Ndryshime/shtesa në Udhëzimin nr. 10, datë 03.04.2015 (licenca e mësuesit).
- 9) Udhëzim nr. 9, datë 24.01.2025 – Ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 13.03.2017 (QSHA).
- 10) Udhëzim nr. 10, datë 27.01.2025 – Provimet kombëtare arsimit bazë 2024–2025.
- 11) Udhëzim nr. 11, datë 07.02.2025 – Vlerësimi i arritjeve në arsimin fillor, 2024–2025.
- 12) Udhëzim nr. 12, datë 24.02.2025 – Ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 (kualifikimi).
- 13) Udhëzim nr. 13, datë 07.03.2025 – Ndryshime/shtesë në Udhëzimin nr. 16, datë 08.07.2019 (regjistrat AL).
- 14) Udhëzim nr. 14, datë 13.03.2025 – Shtesë në Udhëzimin nr. 8, datë 03.05.2024 (portal “Mësues për Shqipërinë”).
- 15) Udhëzim nr. 15, datë 13.03.2025 – Shtesa në Udhëzimin nr. 25, datë 25.07.2018 (Bordi i institucionit arsimor).
- 16) Udhëzim nr. 16, datë 17.04.2025 – Programi CEEPUS IV.
- 17) Udhëzim i përbashkët nr. 266, datë 20.06.2025 – MAS & MSHMS (punësimi me prioritet i mjekëve që përfitojnë trajtim të veçantë).
- 18) Udhëzim nr. 19, datë 28.07.2025 – Provimet kombëtare të arsimit bazë – sesioni i dytë 2024–2025.
- 19) Udhëzim nr. 21, datë 22.08.2025 – Shtesë në Udhëzimin nr. 26, datë 25.11.2019 (mësuesi ndihmës).
- 20) Udhëzim nr. 22, datë 25.08.2025 – Ndryshime/shtesa në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 (procedura AL).
- 21) Udhëzim nr. 23, datë 01.09.2025 – Rregullat/masat për ndalimin e përdorimit të celularëve në APU.

22) Udhëzim nr. 24, datë 11.09.2025 – Ndryshim në Udhëzimin nr. 25, datë 01.12.2023 (mësuesi në dispozicion – pilotim).

Shënim: Konsultimi publik për Planin e Veprimit të Arsimit Digjital 2025–2030 u publikua në RENJK më 04.08.2025: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/856>

Programi _ARSIMI BAZË (09120)

Objektivat

Sigurimi i një arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit, duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies dhe duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grupmoshës së arsimit parashkollor dhe arsimit të detyruar. Synimet kryesore: arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës sipas standardeve evropiane; rritje e aksesit në AP; përfshirja 100% e fëmijëve 5-vjeçarë në klasat përgatitore; rritje e viteve të shkollimit; rritje e autonomisë së shkollave; ulje e braktisjes në AB; tërheqja e fëmijëve romë/egjiptian në AB; rehabilitimi/ndërtimi i kopshteve/shkollave sipas standardeve; rritja e cilësisë së mësimdhënies përmes trajnimeve, laboratorëve shkencorë & IT, krijimi i bibliotekave dixhitale për kurrikulën e AB; shtrirja e shërbimit të punonjësit social dhe psikologut sipas standardeve krahasuese.

Treguesit financiarë 2025

- Fonde të miratuara 2025: **34,272.4 mln** lekë (54.9% e fondeve të MAS).
- Fonde të rishikuara 2025: 35,326.74 mln lekë (55.4% e fondeve të MAS).
 - Me të ardhura nga donatorët: 34,324.6 mln lekë.
- Pesha në % ndaj buxhetit të MAS: 55.4%; ndaj shpenzimeve publike: 4.15%; ndaj PBB: 1.31%.
 - Realizimi Janar –Gusht 2025: 22,456.4 mln lekë (64% e fondit të rishikuar).
- Pesha në realizimet e MAS (8-mujori): 54.5%; ~4.2% ndaj shpenzimeve publike; ~1.3% ndaj PBB.

Tabela nr. 2_ Fondet e miratuar me ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, në lekë per programin “Arsimi Bazë”

Kodi i Progr	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 230	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 604	Art. 605	Art. 606	Total
	Te ardhura jashtë limiti		Shp. Faktike					3,688,430				3,688,430
9120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	2025	Plani fillestar	-	1,537,000,000	26,032,760,000	3,933,574,000	1,869,063,000	0	0	900,000,000	34,272,397,000
9120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	2025	Plani i rishikuar	-	1,477,161,000	26,732,760,000	4,283,574,000	1,894,142,119	0	110,000	939,000,000	35,326,747,119
9120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	2025	Shpenzime faktike	-	547,286,271	17,871,552,513	2,977,138,651	1,030,737,168	0	99500	29,585,180	22,456,399,283
9120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	2025	Angazhime	-	259,940,925	0	0	79,861,865	0	0	0	339,802,790
	Ndryshimi ne vlere absolute	2025		-	669,933,804	8,861,207,487	1,306,435,349	783,543,086	0	10,500	909,414,820	12,530,545,046
